



**DOKUMENTAT STANDARDE TË
KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT PËR
KONTRATAT E PUNËVE CIVILE**

Procedura e Hapur Nderkombetare

**“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin,
Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit
Publik Tiranë”**

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të
Transportit Publik Tiranë”

NJOFTIMI I KONTRATËS

I Autoriteti Kontraktor

Seksioni 1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia e Tiranës
Adresa	Bulevardi “Deshmoret e Kombit”
Tel/Fax	00 355 4 22 56 799
E-mail	prokurimet@tirana.gov.al
Faqja e Internetit	www.tirana.gov.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qendror	Institucion i pavarur
Njesi e Qeverisjes Vendore	
X	

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Lloji i Kontratës

Punë X

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. *Objekti i kontratës: “Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”*

Bashkia e Tiranës ose "**Autoriteti Kontraktor**", fton Operatorët Ekonomikë në një procedurë ndërkombëtare tenderimi për Partneritetin Publik Privat për hartimin e detajuar dhe zbatimin e ndërtimit të një terminali të ri të transportit publik, mirëmbajtjen e tij të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, si dhe menaxhimin e mëvonshëm të terminalit të transportit publik të Tiranës ("**Projekti**"), në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këto dokumente tenderi dhe me kushtet e kontratës . Vlera e vlerësuar e projektit është 15.477.857,31 (pesëmbëdhjetë million e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqinde pesëdhjetë e shtatë presje tridhjetë e një)Euro (pa përfshirë TVSH)

Autoriteti Kontraktor do të zbatojë procedurën e hapur të tenderit në pajtim me nenin 22 të ligjit shqiptar të koncesioneve dhe partneritetit publik privat nr. 125/2013. Autoriteti kontraktor do të

marrë parasysh vetëm ofertat e atyre tenderuesve apo konsorciumet e tenderuesve, të cilët kanë kaluar kufijtë minimalë, të përcaktuara në kriteret e kualifikimit.

Gjatë ndërtimit të terminalit, objektivi i Autoritetit Kontraktor është përmirësimi i lëvizshmërisë së përgjithshme, duke siguruar një terminal me kapacitet të plotë transporti ku autobusët ndërqytetës do të shkarkojnë pasagjerë për në autobusë urbanë dhe taksi përgjatë korridorit kryesor të qytetit në pjesën veriore, perëndimore dhe jugore të vendit, duke zvogëluar bllokimet e trafikut në qendër të qytetit, përmirësimin e ndotjes së ajrit dhe reduktimin e konsumit të karburantit për transport publik.

Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një truall prej 85,000 metra katrorë vendosur përgjatë korridorit kryesor që çon në veri-perëndim, nga qyteti në drejtim të Durrësit, truall i cili do t'i jepet në baza afatgjatë Ofertuesit fitues për të ndërtuar, operuar dhe për të ruajtur terminalin për të mirën e operatorëve dhe udhëtarëve. Në shkëmbim, të gjitha tarifat e vendqendrimit të autobusëve, të ardhurat e qiradhënies me pakicë, dhe tarifat e parkimit, do të arkëtohen nga Operatori Ekonomik për amortizimin e CAPEX-it të tij fillestar, shpenzimet operative, dhe për mbulimin e shërbimit të borxhit.

Tenderimi për kontratën është i hapur për firmat dhe sipërmarrjet e përbashkëta të firmave e çdo vendi të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara me poshte.

2. **Forma e kontratës:** Koncesion/Partneritet Publik Privat
3. **Burimi i financimit :** Sektori Privat

2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja e kontratës PPP të Konkensionit do të jetë deri ne 35 (tridhjetë e pesë) vite.

2.4 Vendndodhja e objektit te kontratës:

Rruga e Kastrioteve, Kthesa e Kamzes, Tirane

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës nr. 9.

3.2 Sigurimi i Ofertës (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor) :

Operatori Ekonomik në një procedurë koncesioni/partneritetit publik privat, paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është e barabartë me 2% të vlerës së parashikuar të projektit ose në shumën prej 310.000 (treqind e dhjetë mijë) Euro

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës:

E hapur	X	E kufizuar negocim	Me me shpallje paraprake
---------	----------	-----------------------	--------------------------------

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Nr.	Kriteri	Rezultati Maks.	Pragu Min/ Rezult. Kalues
TC1	Përputhshmëria me Kriteret Minimale Teknike	2	1
TC2	Korrektësia teknike dhe operationale	34	20
TC3	Sistemet e informacionit	4	2
TC4	Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale	10	
TC4-1	- siguria e brendshme e zonës dhe ndërtesave	4	
TC4-2	- teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë dhe pajtueshmëria me standardet mjedisore	4	
TC4-3	- zvogëlimi i ndikimit mbi trafikun lokal gjatë aktiviteteve të ndërtimit	2	

	KRITERET TOTALE TEKNIKE	50	
FC1	KOHËZGJATJA E KONÇESIONIT	10	
FC2	TARIFA E KONÇESIONIT	10	
FC3	TARIFAT E TERMINALIT	10	
FC4	NDARJA E FITIMIT	10	
	KRITERET TOTALE FINANCIARE	40	
CTC1	AFATI I NDËRTIMIT	10	
	TOTALI	100	

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 27/02/2017 Ora 11:00 :

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 27/ 02/ 2017 (dd/mm/vvvv) Ora 11:00

Vendi: www.app.gov.al

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t’i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave:300 (treqind) ditë

4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip **X** Anglisht **X**
Tjetër _____

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë:

Nëse Po Po Jo **X**
Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DSK/PPP tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DSK/PPP para blerjes së tyre.

5.2ⁱ Vlera e tarifës që duhet të paguhet nga operatori ekonomik në rast të një ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik: _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

5.3 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e DSK/PPP)

Studimi i fisibilitetit i plote dhe projekti paraprak do të terhiqen nga operatorët ekonomik me kerkese drejtuar Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë :

Personi I kontaktit: Z. Genc Kojdheli,
Adresa e-mail: genc.kojdheli@tirana.al

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 04/01/2017

¹ Shtuar me VKM Nr. 401 date 13.5.2015

II. UDHËZIME PËR OFERTUESIT

1. HYRJE

(Autoriteti Kontraktues) ka vendosur të implementojë projektin për _____. Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues do të bëhet në bazë të një procedure konkurruese (lloji i procedurës) sipas kritereve kualifikuese dhe vlerësuese të specifikuara në këtë dokument. Kohëzgjatja e kontratës koncesionare/ ppp _____ nga hyrja në fuqi e saj.

1.1 Informacion i mëtejshëm:

Përshkrim i përgjithshëm

a. POZICIONI GJEOGRAFIK

b. KUSHTET HIDROLOGJIKE (Në rastet e dhënies me koncesion të hidrocentraleve)

c. LIDHJA ME INFRASTRUKTUREN INXHINIERIKE

d. KUSHTET HIDROTEKNIKE (Në rastet e dhënies me koncesion të hidrocentraleve)

e. KUSHTE TE TJERA TE LIDHURA ME OBJEKTIN

1.2 *(vetëm për propozimet e pakërkua)*

Projekt koncesionar _____ është propozimi i pakërkuar i miratuar nga Autoriteti Kontraktues. Bazuar në VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Per miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, shoqëria _____ ka përfituar një bonus prej _____ të totalit të pikëve, ose projekti është vlerësuar _____ lekë.

1.3 Këto udhëzime ("Udhëzimet per Ofertuesit") si dhe “Ftesa për Ofertë” i adresohet të gjithë subjekteve juridike ose bashkimeve të tyre, që kanë për qëllim të marrin pjesë në këtë procedurë konkurruese përzgjedhjeje.

1.4 Shpenzimet: Ofertuesi Fitues duhet të përballojë shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij si dhe çdo shpenzim tjetër ashtu siç parashikohet në këto dokumente në përputhje me nenin 25 dhe nenin 29 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

1.5 Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të ndërprerë përfundimisht këtë Procedurë konkurruese përzgjedhëse. Ofertuesi nuk ka asnjë të drejtë për të kërkuar ndonjë kompensim për kostot ose humbjet.

2. Dokumentet eProcedurës Konkurruese

2.1 Përmbajtja

2.1.1 Lloji i projektit dhe kërkesat teknike, procedura e konkurimit, kushtet e kontratës dhe kërkesat ligjore dhe ekonomike financiare përcaktohen në dokumentat e procedurës konkurruese të cilat përmbajne :

SHTOJCAT

Shtojca 1: Formulari i Ofertës

Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë i Procedurës së Kufizuar ose Me Negociim me Shpallje

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklarate mbi permbushjen e Specifikimeve teknike nga operatori

ekonomik Shtojca 6: Deklarata për konfliktin e interesit

Shtojca 7: Formular i vlerësimit për realizimin e punimeve

Shtojca 8: Deklarata e disponueshmerise se makinerive Shtojca

9: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes Shtojca

10: Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore

Shtojca 11: Kriteret e vlerësimit

Shtojca 12: Vetëdeklarim për ofertuesit e huaj

Shtojca 13: Projekt-zbatimi dhe specifikimet teknike

Shtojca 14: Preventivat

Shtojca 15: Formulari për Njoftimin S’kualifikimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Fituesit Shtojca

17: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Shtojca 18:

Kushtet e Vecanta të Kontratës Shtojca 19: Njoftim i

Nënshkrimit të Kontratës Shtojca 20: Formulari i

Sigurimit të Kontratës

Shtojca 21: Formulari i Ankesës ne Autoritetin Kontraktor

Shtojca 22: Formulari i Prokurës

2.1.2 Çdo ofertues duhet të marrë në konsideratë udhezimet, kriteret, kushtet, specifikimet, afatet dhe të gjithë informacionin në dokumentat e procedurës konkurruese. Në rast se ofertuesi:

- i) nuk plotëson të gjithë dokumentacionin dhe informacionin në dokumentat e procedurës konkurruese; ose
- ii) paraqet nje oferte e cila nuk eshte ne perputhje me kushtet dhe kerkesat e dokumentave te procedures konkurruese.

Autoriteti kontraktues do te percaktoje se oferta nuk eshte ne perputhje me kerkesat e dokumentave te procedures konkurruese dhe do te refuzoje oferten.

2.2 Sqarime mbi Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurruese:

2.2.1 Ofertuesi i cili kërkon sqarime apo ndryshime të dokumentave të procedurës konkurruese, duhet të paraqesë kërkesën e tij nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik. Të gjitha pergjigjet së bashku me sqarimet përkatëse, duhet tu bëhen të njohura te gjithë të interesuarve.

2.3 Ndryshimet në dokumentet e procedurës konkurruese:

- 2.3.1** Në çdo kohë para afatit të dorëzimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues në çdo rast që bën ndryshime në dokumentat e procedurës duhet të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave sipas ligjit. AK mund për çdo arsye, me nismën e tij ose në përgjigje të kërkesave për ndryshime nga një ofertues, të ndryshojë dokumentat e procedurës ofertuese.
- 2.3.2** Të gjitha ndryshimet e kryera nga Autoriteti Kontraktues do të publikohen në faqen e internetit të APP. Dokumentet e ndryshuara do të konsiderohen si dokumentet e procedurës konkurruese për këtë procedurë përzgjedhëse konkurruese.
- 2.3.3** Në mënyrë që ofertuesit të kenë kohë të mjaftueshme për të bërë ndryshimet përkatëse në ofertën e tyre, Autoriteti Kontraktues mund, që me nismën e tij të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues sipas ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, do të publikojë afatin e ri për dorëzimin e ofertave në faqen e internetit të APP.

3. OFERTA: PËRGATITJA

3.1. Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

- a) Formulari i Ofertës, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 1 e DSK/PPP.
- b) Formulari i Sigurimit të ofertës, kur kërkohet, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 3 e DSK/PPP.
- c) Dokumentat që lidhen me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat (*skica, projekte, etj*)

_____,
_____,
_____.

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Çdo e dhënë e rreme do të përbëjë për Autoritetin Kontraktues shkakun ligjor për skualifikimin në çdo kohë të Ofertuesit. Nëse kjo zbulohet ose njoftohet pas lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i japë fund marrëdhënieve të kontratës në mënyrë të njeanëshme dhe të marrë dëmshpërblim për humbjet aktuale. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhënia e informacioneve të rreme, përpilimi i dokumenteve të rreme apo të falsifikuara si dhe çdo deklaratë apo ndonjë e dhënë tjetër, që nuk pasqyron të verteten, konsiderohet vepër penale.

Ofertuesi duhet të përdorë vetem Dokumentat e Procedurës Konkurruese, pa i bërë asnjë ndryshim përmbajtjes së tyre.

3.2 Sigurimi i Ofertës:

- 3.2.1** Si pjesë e ofertës së tij teknike, ofertuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Ofertës, kur kërkohet, sipas Formularit të Sigurimit të Ofertës (Shtojca 3), deri në vlerën 2% të vlerës së projektit të propozuar nga Ofertuesi.

- 3.2.2** Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, është i detyrueshëm të paraqitet në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet. Ofertuesi duhet të garantojë, qe Sigurimi i Ofertës të jetë i vlefshëm për një periudhë _____ ditore pas përfundimit të vlefshmërisë së ofertës, e cila është _____. Pra oferta duhet të sigurohet për _____ nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të saj. Për arsye të motivuara Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, nëse ka patur një të tillë, në rast se rrethana të caktuara ndikojnë në shtyrjen e afatit të vlerësimit të ofertës përkatëse ose në dorëzimin e Sigurimit të Kontratës ose në çdo rast tjetër që ndikon në shtyrjen e ndonjë afati të detyrueshëm. Mos shtyrja e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, kur kërkohet përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit.
- 3.2.3** Sigurimi i Ofertës, nëse është kërkuar, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Çdo oferte e pashoqeruar me Sigurimin e Ofertes do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertes.
- Sigurimi i Ofertes duhet të paraqitet në emër të:
- i) shoqërisë, në rast se Ofertuesi është një shoqëri e vetme; ose
 - ii) në emër të shoqërisë kryesuese në rast se Ofertuesi është një bashkim i perkohshëm i shoqërive.
- 3.2.4** Me kërkesë të Ofertuesit jofitues, Autoriteti Kontraktues do t'i kthejë atij Sigurimin e Ofertës, kur është kërkuar, sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës apo çdo zgjatje të afatit të saj.
- 3.2.5** Sigurimi i ofertës, i Ofertuesit Fitues, kur është kërkuar, do t'i kthehet atij pas dorëzimit të Sigurimit të Kontratës pranë Autoritetit Kontraktues.
- 3.2.6** Sigurimi i ofertës mund të mbahet nga Autoriteti Kontraktues, kur është kërkuar, në rastet kur Ofertuesi:
- i) tërheq ofertën e tij gjatë procedurës konkurruese pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;
 - ii) nuk paraqet Sigurimin e Kontrates (në rast se shpallet fitues);
 - iii) nuk nënshkruan kontratën koncesionare (në rast se shpallet fitues) brenda afateve kohore të specifikuara në Formularin e Njoftimit të Fituesit (Shtojca 16);
 - iv) ka deklaruar të dhëna të rreme në ofertën e tij;
 - v) në rast se shpallet fitues dhe refuzon pagesën e shpenzimeve sipas pikes 1.4 me sipër.
- 3.3 Prokura:** Çdo Ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Perkohshëm, kur Ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë një prokurë noteriale, në formën e percaktuar në Shtojcën 22, që tregon se personi (personat) që kanë nënshkruar Ofertën kanë të drejtën e nënshkrimit të saj.
- 3.4 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertes:**
Ofertat duhet të jenë të vlefshme për _____ duke filluar nga momenti i përfundimit të “afatit kohor për dorëzimin e ofertave”. Një oferte me një vlefshmeri më të shkurtër se

afati i percaktuar do te refuzohet nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave si e papranueshme.

Ne menyre perjashtimore, Autoriteti Kontraktues mund te kerkoje nga Ofertuesi zgjatjen e Periudhes se Vlefshmerise se Ofertes. Kerkesa e Autoritetit Kontraktues dhe pergjigja e Ofertuesit duhet te jene ne forme te shkruar. Ne rast te zgjatjes se Afatit te Vlefshmerise se Ofertes, edhe afati i Sigurimit te ofertes, nese është kërkuar, do te zgjatet ne perputhje me piken 3.2.2.

3.5 Formati dhe nënshkrimi i Ofertës

3.5.1 Çdo ofertues duhet të përgatisë dhe dorëzojë ofertën në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Informacione të detajuara lidhur me ngarkimin e ofertës gjenden në manualin e përdorimit, i cili është publikuar në adresën <https://ëëë.app.gov.al>.

3.5.2 Ofertuesi, i cili do të shpallet fitues i konkurimit, do të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues ofertën origjinale. Oferta origjinale duhet të jetë e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi ose personat me të drejtë nënshkrimi (te autorizuar me prokuren e dorezuar si pjese te Ofertes Teknike , ne perputhje me piken 3.3. duhet te nënshkruajnë Oferten duke:

i) Nenshkruar origjinalin e ofertes; dhe

ii) Shenuar inicialet ne secilen faqe te origjinalit te dokumentave qe shoqerojne oferten ekonomike.

3.5.3 Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim te rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.

4. DOREZIMI I OFERTES ORIGJINALE

4.1 Formati dhe nënshkrimi i ofertës

4.1.1. Në zbatim të VKM Nr. 268, date 18.4.2012 “Për kryerjen në menyrë elektronike të procedurave konkurruese te dhënies së koncesionit” dhe VKM Nr. 575 datë 10.7.2013, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve/partneritetit publik privat”, oferta do te dorezohet ne format elektronik ne perputhje me udhezimet e Agjencise se Prokurimit Publik. Nje informacion me te qarte te kesaj procedure do te gjeni ne faqen zyrtare ëëë.app.gov.al.

4.1.2 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnje pergjegjesi ndaj cdo Ofertuesi ndaj cdo pretendimi apo ankese mbi paqartesi ne menyren e dorezimit te Ofertes me perjashtim te rastit kur nje oferte nuk sigurohet ne menyren e duhur per shkak te mungeses se infrastruktures se duhur nga ana e Autoritetit Kontraktor.

4.1.3 Në cdo rast, Ofertuesit duhet te dorëzojnë në formë **elektronike** te gjithë dokumentacionin e detyrueshëm si dhe të nevojshëm për prezantimin e ofertës së t yre .

4.1.4 Ofertuesi i shpallur fitues duhet të dorëzojë ofertën origjinale pranë Autoritetit Kontraktues. Oferta origjinale duhet të vendoset në një zarf/kuti, të jetë e mbyllur dhe e vulosur. Mbi zarf/kuti duhet të jetë pasqyruar emri dhe adresa e ofertuesit si dhe shënimi: Ofertë për projektin “_____”.

Oferta origjinale duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme:

Drejtuar:	(Autoriteti kontraktor)
Në vemëndje:	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Adresa:	

4.2 Afati për dorëzimin e Ofertave

4.2.1 Ofertat duhet të dorëzohen në faqen e internetit të APP brenda datës _____, ora _____. Ofertuesi i shpallur fitues do të njoftohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues për afatin e dorëzimit të ofertës origjinale.

5. HAPJA DHE VLERESIMI I OFERTAVE

5.1 Hapja e Ofertave

5.1.1 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bën identifikimin e ofertuesve dhe hapjen e ofertave të dorëzuara në faqen e internetit të APP pas mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

5.2 Vlerësimi i Ofertave

5.2.1 Pas hapjes së ofertës Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do t’u shqyrtojë atë për të përcaktuar nëse oferta është e pranueshme, nëse dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar, nëse dokumentacioni i kërkuar për tu nënshkruar nga ofertuesi është nënshkruar rregullisht, dhe nëse Oferta është e rregullt.

5.2.2 Vlerësimi i Autoritetit kontraktues do të bazohet në të dhënat dhe vetë përmbajtjen e Ofertes duke mos iu drejtuar burimeve të tjera. Megjithatë, nëse është e nevojshme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë sqarime nga Ofertuesit, të cilat nuk përbejnë një ndryshim të thelbit të Ofertes. Sqarimet duhet të jenë vetëm me shkrim ose/dhe të reflektuara në procesverbalin përkatës. Gjithashtu në rast të veçanta Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e tij për të përfshirë edhe eksperte të ndryshëm

te cilet mund te ndihmojne ne trajtimin e atyre ceshtjeve per te cilat Komisioni i Vleresimit te Ofertave has veshtiresi.

5.2.3. Oferta do te konsiderohet e pavlefshme nese:

- i) ofertuesi nuk ka dorezuar Sigurimin e Ofertes, nese është kërkuar;
- ii) oferta permban te dhena te rreme;
- iii) nuk ka plotësuar një ose te gjitha kërkesat e ftesës per procedurën konkurruese.

5.2.4 Komisioni i Vleresimit te Ofertave vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te cilat nuk ndryshojne materialisht ose nuk devijojne nga karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentat e procedures perzgjedhese, apo gabime, te cilat mund te korrigojohen pa prekur permbajtjen e saj.

5.2.5 Nëse më shumë se një ofertë financiare ka të njëjtën vlerë ose ka pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve.

5.2.6 Komisioni i Vlerësimit te Ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili duhet te njoftohet publikisht dhe t'i komunikohet Ofertuesve. Pas njoftimit te klasifikimit përfundimtar, çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vleresimit te Ofertave është në kundërshtim me parashikimet e Ligjit Nr. 125/2013 “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM nr. 575, datë 10.7.2013 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve/partneritetit publik privat", duke perdorur formularin e Ankimit te Procedures Konkurruese, te percaktuar ne Shtojcen 21.

5.2.7 Me mbarimin e procedures ankimore Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pergatit raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe i propozon Kryetarit te Autoritetit Kontraktues, rezultatet e arritura per secilin prej ofertuesve.

5.3 Pavlefshmëria dhe Mossuksesi i Procedurës Konkurruese

Procedura konkurruese quhet e pasuksesshme kur:

- i) Asnje nga ofertat e paraqitura nuk permbush kerkesat e fteses per procedurë konkurruese;
- ii) Autoriteti kontraktues, për mungesë të leverdisë ekonomike të ofertave ose të vetë projektit, shpall mbylljen e procedurës konkurruese;
- iii) Ose kur nuk ka pjesmarres ne gare.

5.4 Veprimet e kundraligjshme

Në përputhje me legjislacionin per parandalimin e konfliktit te interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një ofertë, nese Ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i) i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së konkurrimit; dhe/ose

- ii) është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si psh – një ofertues është i lidhur me një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me procedurën konkurruese, apo ka lidhje me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- iii) Ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentet Standarte të Procedures Konkurruese.

Autoriteti Kontraktues e informon me shkrim ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e konkurimit.

5.5 Percaktimi i Ofertuesit Fitues dhe Nenshkrimi i Kontrates

5.5.1 Pas perfundimit të afatit të ankimit, të përcaktuar në pikën 5.2.6, Autoriteti Kontraktues informon Ofertuesin, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, përmes dërgimit të Njoftimit të Fituesit , siç parashikohet në Formularin e Njoftimit të Fituesit. Një kopje e zgjeruar e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike. Gjatë nënshkrimit, Autoriteti Kontraktues i kërkon Ofertuesit Fitues paraqitjen e Sigurimit të Kontratës.

Formulari i Sigurimit të Kontratës, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet sipas pikes 5.5.3.

Sigurimi i Kontrates mund të dorëzohet në formën e një:

- i) garancie bankare e pakushtëzuar ose
- ii) nepermjet një police sigurimi.

5.5.2 Autoriteti Kontraktues dhe Ofertuesi Fitues do të negociojnë në mirebesim kushtet dhe afatet perfundimtare të Kontrates Koncesionare/Partneritetit Publik Privat, duke pasur parasysh se Ofertuesi Fitues do të kerkohet të nënshkruajë Kontraten Koncesionare sipas Kushteve të Veçanta dhe të Pergjithshme të Kontrates të nënshkruara nga ai në çdo faqe dhe të dorëzuar si pjesë e Ofertes Teknike, të ndryshuara (nese është e aplikueshme) gjatë procesit të negocimit të Kontrates Koncesionare/ Partneritetit Publik Privat.

5.5.3 Nëse brenda një afati kohor _____ nga data e Njoftimit të Fituesit dhe afatit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave behet e qarte se, nëse Ofertuesi Fitues (për arsye të pajustificuara) nuk do të dorëzojë Sigurimin e Kontrates dhe/ose nuk do të nënshkruajë Kushtet e Veçanta dhe të Pergjithshme të Kontrates, Autoriteti Kontraktues do t'i mbaje Ofertuesit Fitues, Sigurimin e Ofertes, nëse është kërkuar, dhe do të ftojë Ofertuesit e tjerë, sipas radhës në klasifikimin perfundimtar, deri sa të marre Sigurimin e Kontrates dhe Kushtet e Pergjithshme dhe të Veçanta të nënshkruara në çdo faqe nga Ofertuesit sipas radhës , apo të refuzojë të gjitha Ofertat e mbetura.

5.5.4 Autoriteti Kontraktues do të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e Koncesionarit dhe termat kryesore të Kontrates Koncesionare, brenda 30 diteve nga nënshkrimi i kontrates.

5.5.5

Shtojca 2

(Shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)

FTESA PER OFERTE¹

Bashkia Tiranë

fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Puneve të mëposhtme:

Bashkia e Tiranës ose "**Autoriteti Kontraktor**", fton Operatorët Ekonomikë në një procedurë ndërkombëtare tenderimi për Partneritetin Publik Privat për hartimin e detajuar dhe zbatimin e ndërtimit të një terminali të ri të transportit publik, mirëmbajtjen e tij, si dhe menaxhimin e mëvonshëm të terminalit të transportit publik të Tiranës ("**Projekti**"), në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këto dokumente tenderi dhe me kushtet e kontratës . Vlera e vlerësuar e projektit është 15.477.857,31 (pesëmbëdhjetë million e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqinde pesëdhjetë e shtatë presje tridhjetë e një)Euro (pa përfshirë TVSH)

Autoriteti Kontraktor do të zbatojë procedurën e hapur të tenderit në pajtim me nenin 22 të ligjit shqiptar të koncesioneve dhe partneritetit publik privat nr. 125/2013. Autoriteti kontraktor do të marrë parasysh vetëm ofertat e atyre tenderuesve apo konsorciumet e tenderuesve, të cilët kanë kaluar kufijtë minimalë, të përcaktuara në kriteret e kualifikimit.

Gjatë ndërtimit të terminalit, objektivi i Autoritetit Kontraktor është përmirësimi i lëvizshmërisë së përgjithshme, duke siguruar një terminal me kapacitet të plotë transporti ku autobusët ndërqytetës do të shkarkojnë pasagjerë për në autobusë urbanë dhe taksi përgjatë korridorit kryesor të qytetit në pjesën veriore, perëndimore dhe jugore të vendit, duke zvogëluar bllokimet e trafikut në qendër të qytetit, përmirësimin e ndotjes së ajrit dhe reduktimin e konsumit të karburantit për transport publik.

Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një truall prej 85,000 metra katrorë vendosur përgjatë korridorit kryesor që çon në veri-perëndim, nga qyteti në drejtim të Durrësit, truall i cili do t'i kontraktohet në baza afatgjatë Ofertuesit fitues për të ndërtuar, operuar dhe për të ruajtur terminalin për të mirën e operatorëve dhe udhëtarëve. Në shkëmbim, të gjitha tarifatat e vendqendrimit të autobusëve, të ardhurat e qiradhënies me pakicë, dhe tarifatat e parkimit, do të arkëtohen nga Operatori Ekonomik për amortizimin e CAPEX-it të tij fillestar, shpenzimet operative, dhe për mbulimin e shërbimit të borxhit.

Tenderimi për kontratën është i hapur për firmat dhe sipërmarrjet e përbashkëta të firmave e çdo vendi të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara me poshte.

Vendi i kryerjes së kontratës së punës

Rruga e Kastriotëve, Kthesa e Kamzes, Tirane

Afati i ekzekutimit të kontratës Kohëzgjatja e kontratës PPP të Konkensionit do të jetë deri 35 vite.

Oferta duhet të paraqitet

Elektronikisht në web site të app-së www.app.gov.al

Përpara

Data e hapjes: 27/02/2017 , ora 11:00

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të ëeb-it të APP-së, ëëë.app.gov.al.

¹ Kjo shtojcë është e aplikueshme për procedurën e kufizuar dhe procedurën me negociim me shpallje paraprake

Shtojca 3

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojce per tu paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emer të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

Procedura e koncesionit/partneritetit publik privat [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]/*Nr.Referencës në faqen e APP-se*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nese eshte percaktuar keshtu ne dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se koncesionit/partneritetit publik privat kur autoriteti kontraktor e kerkon nje gje te tille;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta eshte shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonje kusht tjeter perpara nenshkrimit te kontrates se percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm [] ditë, nga data e mbarimit të afatit të dorëzimit të ofertave në faqen e internetit të APP-së.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

(Shënoni më poshtë informacinin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DSK/PPP që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

Shtojca 5

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATE E PERMBUSHJES SË KËRKESAVE TË DOKUMENTAVE STANDARTE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____

Une i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

Permbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e Koncesionit/Partneritetit publik Privat dhe i pranojmë pa rezerva dhe asnjë vërejtje ato. Deklarojmë nën përgjegjësinë tonë ligjore se jemi dakord me të gjitha specifikimet teknike të dhëna dhe i plotësojmë ato sipas përcaktimit në dokumentat e Koncesionit/Partneritetit publik Privat. Në përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, finansiare-ekonomike si dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat standarte të procedurës konkurruese, dhe vërtetojmë këtë me certifikata dhe dokumenta, të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentat standarte për procedurën konkurruese.

Nuk do të marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë për këtë procedurë konkurruese.

Në autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/ dokumentat që i bashkëlidhën kësaj oferte.

Në rast se oferta jonë pranohet në do të bëjmë sigurimin e kontratës, sic parashikohet në dokumentat standarte të procedurës konkurruese.

Në rast se shpallemi fitues të procedurës konkurruese, biem dakord për të nënshkruar Kontratën sipas formularit të kushteve të kontratës.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[Shtojce për tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvmministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/partneritetin publik privat”.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[*Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

FORMULAR VLERESIMI

(Ky formular do te shoqerohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VERTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nenshkruar kontraten me	
Emri i operatorit NIPT/	
Bashkimit te operatoreve NIPTET/	
Nenkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontrates:	
Data e fillimit te kontrates	Data e mbarimit te kontrates
Vlera sipas kontrates	Vlera e realizuar
% e bashkimit te O.E. dhe pershkrimi i puneve te kryera nga secili anëtar	
Nenkontraktoret.	
Vleresimi	(shprehur me fjale)
	E permbushur
	E papermbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 8

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zoteron mjetet pajisjet teknike dhe asete te tjera fizike per te realizuar kontraten me objekt: _____

Ne pronesi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasise	Te tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit Te mjetit	Nr. Shasise Se mjetit	Nr. Kont se qerese (noterise)	Afati i kontrates qerese(Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhene ne kete table.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nenshkrimi Vula

Shtojca 9

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit
Publik Tiranë”

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) nuk është në proces falimentimi,
 - b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, të lëshuar nga Qendra Kombetare të Regjistrimit.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 10 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këto kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas se ciles bashkimi i operatoreve ekonomik është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posacme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Sigurimi i ofertes, sipas Shtojces 3;*
- b. *Deklarate mbi permbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojces5;*
- c. *Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojces 6;*
- ç. *Përshkrimi i Ofertës i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur, sipas Shtojces 1;*
- d. *Formular vleresimi sipas Shtojces 7;*
- e. *Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve sipas Shtojces 8.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011,2012,2013,2014,2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
- b. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011,2012,2013,2014, 2015) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se vlera e projektit perkatesisht: **15.477.857,31**(pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë presje tridhjetë e një) **Euro pa TVSH.**
- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016;
- d. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.
- e. Ofertuesi duhet të demonstrojë me anë të dokumentacionit respektiv se ka qasje ose ka në dispozicion, aktive likuide, pasuri të paluajtshme të pa bllokuara, linja krediti, si dhe mjete të tjera financiare të mjaftueshme për të përmbushur fluksin monetar të ndërtimit për kontratën për një periudhë prej pesë muajsh, vlerësuar jo më pak se 3,500,000 euro (tre milionë e pesëqind mijë), duke marrë parasysh angazhimet e aplikantit për kontratat e tjera.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Eksperiencë në Ndërtim

Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

1. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin e godinës përkatësisht në vlerën 2.600.000 (dy million e gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH, e realizuar pesë vitet e fundit ose
2. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së përlllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin e godinës përkatësisht **12.000.000 (dymbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:
 2. Kontratë
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Certifikaten e marrjes ne dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:
 2. Kontrate;
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Akt kolaudimi objekti;
 5. Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
 6. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Pika 1 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b. Eksperiencë në Punime Rrugore

Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

3. Punë të ngjashme për një kontratë në infrastrukturën rrugore të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të projektit lidhur me infrastrukturën rrugore përkatësisht në vlerën 4.500.000 (katër milion e pesëqind mijë) Euro pa TVSH, e realizuar pesë vitet e fundit ose
4. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së përlogaritur të projektit lidhur me ndërtimin në infrastrukturën rrugore **18.000.000 (tetëmbëdhjetë milion)** Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- c) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 6. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:
 7. Kontratë
 8. Situacionin përfundimtar;
 9. Aktin e kolaudimit;
 10. Certifikaten e marrjes në dorezim.
- d) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 7. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:
 8. Kontrate;
 9. Situacionin përfundimtar;
 10. Akt kolaudimi objekti;
 11. Certifikaten e marrjes në dorezim të objektit;
 12. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 3 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 4 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

c. Eksperiencë operacionale dhe mirëmbajtjeje

Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktor kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor, brenda pesë viteve të fundit.

1. Shërbime të ngjashme me objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat me vlerë 40% e vlerës sëpërlllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: **300.000** (treqind mijë) Euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (*ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara*).

d. Eksperiencë në Projektim

Ofertuesi ose një nënkontraktor i specializuar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Xhiron mesatare vjetore si kontraktori kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor (përkufizuar si faturim për punët rrugore në progres dhe të përfunduara) gjatë 5 (pesë) viteve të fundit prej 500.000 (pesëqind mijë) Euro

(b) përvojë të suksesshme si Kontraktor kryesor, anëtar sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor në projektimin e

- të paktën një projekt dizanji me një vlerë 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH; e realizuar pesë vitet e fundit ose

- projekte të shumta dizanji (prjektimi) me një vlerë 600,000 (gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH , të realizuara pesë vitet e fundit

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktor kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkon-traktor, brenda pesë viteve të fundit.

e. **Eksperiencë në Punime në infrastrukturë rrugore ose infrastrukturë Civile**
Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

5. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme në infrastrukturën rrugore ose infrastrukturë civile me një vlerë jo më të vogël se 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, e realizuar gjatë pesë vitet të fundit **ose punë në vazhdimësi**

6. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë prej 24.000.000 (njëzetë e katër milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit **ose punë në vazhdimësi**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët e përfunduara

e) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

11. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:
12. Kontratë
13. Situacionin përfundimtar;
14. Aktin e kolaudimit;
15. Certifikaten e marrjes ne dorezim.

- f) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
13. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:
 14. Kontrate;
 15. Situacionin përfundimtar;
 16. Akt kolaudimi objekti;
 17. Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
 18. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët në vazhdimësi:

- **Kontratë**
- **Fatura Tatimore deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës**
- **Situacionet deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës**
- **Vertetim nga investitori per vleren e realizuar deri ne 30 dite para dates se zhvillimit te procedures**

2.4 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP – 1 D (Punime gërmimi në tokë)
- NP- 2 F (*Ndertime civile dhe industriale*)
- NP-3 C (Rindërtim dhe Mirëmbajtje e ndërtesave Civile dhe Industriale)
- NP-4D(Rrugë, Autostrada, Ura, etj.,
- NS-1C (*Punime per prishjen e ndertimeve*)
- NS-2B(*Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre*)
- NS-3B(*Impiante lëvizjeje dhe transporti (ashensorë, shkallë, lëvizës, transportues)*)
- NS – 4C (*Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese*)
- NS-5B(*Implementim i sinjaleve me ndricim të trafikut*)
- NS-6A(*Sinjalistikë e pa ndriçuar rrugore*)
- NS-7B(*Barriera dhe Mbrojtje Rrugore*)
- NS-8A(*Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri*)
- NS-9C(*Punime të posaçme strukturore*)
- NS-10B(*Shtresa dhe struktura të veçanta*)
- NS-12D(*Instalime teknologjike, ngrohje dhe ajër i kondicionuar*)
- NS-13C(*Implementim i linjave telefonike dhe sistemeve të telekomu-nikacioni*)
- NS-14D(*Instalime të brendshme, elektrike, telefon, TV, etj*)
- NS-19B(*Sisteme izoluese të zhurmës për projektet infrastrukturore*)

- sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt (drejtuesi teknik duhet të ketë mbi 20 (njëzetë) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në librezën e punës), të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplome

4. Një punësim mesatar i të paktën 300 (treqind) personave, për periudhën Janar 2014 - Dhjetor 2016 të vërtetuar me;

4.1 Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2014 - Dhjetor 2016

4.2 Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2014 - Dhjetor 2016 shoqëruar me formularet e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Janar 2015 - dhjetor 2016:

- Inxhinier Ndërtimi (4)
- Inxhinier Topograf (2)
- Inxhinier Elektrik (1)
- Inxhinier Elektronik(3)
- Inxhinier Mekanik (2)
- Inxhinier Mjedis (1)
- Inxhinier Informatik (1)

- Inxhinier Hidroteknik (1)
 - 5.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa per gjashtë muajt e fundit **te pakten 30 punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT, ku nga keta te jene te pakten:**
 - **Grupi I- 7 (shtatë) punonjës**
 - **Grupi II-10 (dhjetë) punonjës**
 - **Grupi III- 9(nëntë) punonjës**
 - **Grupi IV-3 (tre) punonjës**
 - **Grupi V- 1 (një) punonjës)**
 - **(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik)**
 - **Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.**
 - 5.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e vlefshme për periudhën e ndërtimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën dy vitet e fundit, përkatësisht periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2016. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të paktën antari kryesues I bashkimit duhet të plotësojë këtë kusht të ketë 1 mjek ndërmarrjeje.
6. Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten **ISO 9001- 2008**(Sistemi I menaxhimit të cilësisë) (e vlefshme).
7. Shoqëria duhet te paraqesë Certificate **ISO 14001-2004** (Sistemi I menaxhimit të mjedisit)(e vlefshme).
8. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007** (Sistemi I menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)(e vlefshme)
9. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012** (Sistem I integruara I menaxhimit)(e vlefshme)
10. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012**(Menaxhimi I sigurisë së trafikut rrugor) (e vlefshme)
11. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 27001-2013** (Sistemi I menaxhimit të sigurisë së informacionit) (e vlefshme)
12. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO SA 8000-2014** (Sistemi I menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore) (e vlefshme)

13. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 50001-2011** (Sistem I menaxhimit të energjisë) (e vlefshme)

14. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO EN 3843-2-2006** (Menaxhimi I cilësisë në proces të punimeve me Saldim) (e vlefshme)

15. Shoqëria duhet të paraqesë Licence III.2.A (1+2) Ndikimi në mjedis Auditim Mjedisor

16.Licence kodi III.7.A Shërbime profesionale për projekttime,Shërbime profesionale për zbatime

17.Licence III 1.A Lejë mjedisi tipi C . Pikë shërbimi për riparim automjesh

18.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 8)

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti total mbajtës mbi 75 ton pra kapaciteti mbajtes per nje kamion minimum 15 ton)	5 copë	Pronësi ose me qera
Autobetonierë	5 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë e vogël (Tip Bocat)	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë me goma	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	3 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	3 copë	Pronësi ose me qera
greider	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobitmatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtuese	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul vibrues 15 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul me goma për asfalt	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamiocina 1.5-2 ton secila nga kamiocinat	4 copë	Pronësi ose me qera
Çekiç pneumatik/hidraulik për thyerje dhe ngjeshje	3 copë	Pronësi ose me qera
Frezë Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Fshesë për pastim e larje rrugësh	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat GPS për punimet topogjeodezike	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinxh	2 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e

realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 8. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) (e detyrueshme) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në 10 ditë para zhvillimit të procedurës së Koncesionit të Partneritetit Publik Privat në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shpeshë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën koncensionit/ppp që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktues _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

KRITERET E VLERESIMIT

Ofertat do te vleresohen ne baze te kriterëve te meposhteme, dhe fitues do te konsiderohet ai ofertues qe ka pike me teper ne baze te kriterëve te vleresimit.

Komisioni i Vlersimit te Ofertave do te vleresoje Ofertat Teknike dhe Financiare, ne baze te kriterëve te meposhtme:

VLERESIMI I OFERTAVE

Kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	Kriteri	Rezultati Maks.	Pragu Min/ Rezult. Kalues
TC1	Përputhshmëria me Kriteret Minimale Teknike	2	1
TC2	Korrekhtësia teknike dhe operacionale	34	20
TC3	Sistemet e informacionit	4	2

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

TC4	Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale	10	
TC4-1	- siguria e brendshme e zonës dhe ndërtesave	4	
TC4-2	- teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë	4	
TC4-3	dhe pajtueshmëria me standardet mjedisore - zvogëlimi i ndikimit mbi trafikun lokal gjatë aktiviteteve të ndërtimit	2	
	KRITERET TOTALE TEKNIKE	50	
FC1	KOHËZGJATJA E KONÇESIONIT	10	
FC2	TARIFA E KONÇESIONIT	10	
FC3	TARIFAT E TERMINALIT	10	
FC4	NDARJA E FITIMIT	10	
	KRITERET TOTALE FINANCIARE	40	
CTC1	AFATI I NDËRTIMIT	10	
	<i>TOTALI</i>	100	

KRITERET TEKNIKE

Kriteret e vlerësimit teknik, duke përfshirë rezultatet dhe pragjet minimale / rezultatet kaluese (kur është e përshtatshme) përshkruhen më poshtë. Vlerësimi do të kryhet nga Komiteti i Vlerësimit, i asistuar nga ekspertë specifikë për fushat kyçe, dhe do të marrë në konsideratë elementët e përshkruar më poshtë.

TC1: Pajtueshmëria me Kushtet Minimale Teknike - 2 pikë (pragu minimal / rezultat kalues - 1 pikë).

Çdo Ofertues duhet të respektojë kufizimet minimale teknike të përcaktuara në **Kriteret Minimale Teknike (Shtojca 13 Specifikimet Teknike)**. Koncepti kryesor që do të mbahet është që këto propozime të cilat nuk përputhen me këto kërkesa themelore do të skualifikohen.

TC2: Korrektësia teknike dhe operacionale - 34 pikë (pragu minimal / rezultat kalues- 20 pikë).

Korrektësia teknike dhe operacionale do të vlerësohet në bazë të dizenjos së projektit, planit të biznesit, afatit të realizimit dhe cilësisë së shërbimeve dhe masave për të siguruar vazhdimësinë e tyre.

Dizanji i Projektit – përshtatshmëria e arranzhimeve të projektit dhe karakteristikave të tij, cilësia e Raportit të Dizajnit Paraprak, kriteret e cilësisë që do të zbatohen.

Dizanji i Projektit duhet të përmbajë një **Raport Dizanji Paraprak** dhe një **Raport mbi Efikasitetin Operacional**;

Raporti i Dizajnit Paraprak duhet të japë një përshkrim të përgjithshëm teknik të ndërtimit dhe instalimeve dhe të përfshijë detaje mbi

Përshkrimin dhe specifikimin e materialeve që do të përdoren për të përfunduar ndërtesat dhe zonat e terminalit

Instalimet për të rritur komoditetin e udhëtarëve si shkallë dhe ashensorë;

Sistemet e propozuara të informacionit, për shembull për pagesat, sistemet e njohjes së numrit të kompjuterizuar të targave, sistemet për caktimin e automjeteve në hyrje për të arritur përdorimin më të mire të vendeve të parkimit, sistemet për monitorimin e flukseve të trafikut dhe okupimin e vendeve të parkimit;

Teknikat dhe zgjidhjet novatore për sistemin e ndriçimit (si të zakonshëm ashtu edhe për emergjencat) do të vlerësohen mbi bazën e qëndrueshmërisë së tyre teknike, plotësisë së mbulimit të propozuar brenda terminalit, konsumin e tyre të energjisë, rritjes së nivelit të sigurisë në lidhje me ndriçimin në raste emergjente, zbatimin e zgjidhjeve backup, zgjidhjet anti-panik në zonat me rrezik të lartë;

Raporti mbi Eficencën Operacionale duhet të japë një përshkrim të përgjithshëm të operacioneve dhe të përfshijë detaje për:

- Mekanizmin e Pagesave dhe propozimet mbi integrimin e faturimit të biletave për shërbime të ndryshme;
- Përmbajtja e Raporteve Mujore Operacionale që do ti dorëzohen Bashkisë së Tiranës;

Plani i Biznesit – Analiza e Kostos dhe e të Ardhurave dhe Vlerësimi i Kostove të Përsëritura, duke përfshirë një Plan Investimi, Deklaratën Fitim & Humbje, Pasqyrën e Fluksit të Parasë dhe analizën e ndjeshmërisë.

Programi i Zbatimit –Koha e lejuar për kontrollet në terren, projektin e detajuar, ekzekutimin e projektit të ndërtimit, duke përfshirë prodhimin, shpërndarjen dhe instalimin e pajisjeve teknike. Gjatësia e periudhës së ndërtimit dhe koha për fillimin e funksionimit të terminalit duhet të jetë në përputhje me periudhën e ofruar në ofertën financiare.

Cilësia e shërbimeve dhe masave për të siguruar vazhdimësinë e tyre - Ofertuesit duhet të dorëzojnë programet e Mirëmbajtjes së tyre Kryesore dhe të Mirëmbajtjes Specifike për instalimet e ndërtesave dhe ato teknike, si dhe të masave të tjera për të siguruar funksionimin e mirë të objekteve deri në skadimin e periudhës së Konkensionit. Raporti mbi cilësinë e shërbimeve duhet të tregojë disponueshmërinë e tyre të garantuar dhe treguesit relativë të performancës;

TC3: Sistemet e Informacionit - 4 pikë (pragu minimal/ rezultat kalues - 2 pikë).

Sistemet informative për udhëtarët në mbërritjen dhe nisjen e autobusëve dhe tramvajëve / trenave dhe për përdoruesit e vendit të parkimit në lidhje me disponueshmërinë dhe aksesin në parkim do të vlerësohen mbi bazën e qëndrueshmërisë së tyre teknike, plotësinë e informacionit të propozuar, përhapjen e paneleve informative brenda terminalit dhe disponueshmërinë e informacionit nëpërmjet internetit.

TC4: Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale - 10 pikë(nuk ka prag minimal/ rezultat kalues).

Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale do të vlerësohet duke marrë në konsideratë:

- sigurinë e brendshme të zonës dhe ndërtesave përmes një propozimi që ofron sisteme të tilla si kontroll të hyrjes, kamera, mundësinë për të përdorur telefonat celularë në çdo vend brenda terminalit, shërbimet e sigurisë (numrin e personave, turnet), etj (TC4-1 rezultati maksimal 4 pikë)

- teknika inovative në fushën e kursimit të energjisë dhe pajtueshmëri me standardet mjedisore (TC4-2 rezultati maksimal 4 pikë)

- propozimin për të reduktuar, gjatë aktiviteteve ndërtimore, përfshirjen e rrugëve të zakonshme dhe ndikimin në trafikun lokal (TC4-3 rezultati maksimal 2 pikë)

$$TC4_i = TC4-1_i + TC4-2_i + TC4-3_i$$

TC: Rezultati Teknik – maksimumi 50 pikë

$$TC_i = TC1_i + TC2_i + TC3_i + TC4_i$$

KRITERET FINANCIARE

FC1: Kohëzgjatja e Periudhës së Konkensionit – maksimumi 10 pikë

Rezultati për Kohëzgjatjen e Periudhës së Konkensionit (maksimumi 35vjet, minimum 15 vjet) llogaritet si vijon:

$$FC1_i = 10 \times CP_{\min}/CP_i$$

ku:

$$FC1_i = \text{Pikët totale të Periudhës së Konkensionit për Propozimin (i)}$$

$$CP_i = \text{Periudha e Konkensionit në Propozim (i) (muaj)}$$

$$CP_{\min} = \text{Periudha Minimale e Konkensionit në të gjithë Propozimet (muaj)}$$

Ku Periudha e Konkensionit e ofruar nga Ofertuesi është më pak se 180 muaj (15 vjet), CP_i do të jetë e njëjtë më 180 dhe rrjedhimisht edhe CP_{\min} është e barabartë me 180.

Ku Periudha e ofruar e Konkensionit tejkalon 420 muaj (35 vjet), oferta do të përjashtohet si jo-e përgjegjshme.

Periudha e Konkensionit ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2.2 (a) të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

FC2: Tarifa e Konkensionit – maksimumi 10 pikë

Çdo vit gjatë Fazës Operacionale, Partneri Privat do të sigurojë falas Autoritetin Kontraktor me të paktën një për qind (1%) të të ardhurave bruto vjetore, në mënyrë të detajuar në nenin 16.1 të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat ("Tarifa e Konkensionit").

Ofertuesit duhet të japin ofertën e tyre të barabartë, ose mbi këtë përqindje prej 1% të të ardhurave bruto vjetore.

$$FC2_i = 10 \times [(CF_i - 1\%) / (CF_{\max} - 1\%)]$$

ku:

$$FC2_i = \text{Rezultati i Tarifës së Konkensionit për Ofertuesin (i)}$$

$$CF_i = \text{Tarifa e Konkensionit të propozuar nga Ofertuesi (i) (në \%)}$$

$$CF_{\max} = \text{Tarifa më e lartë e Konkensionit e ofruar midis të gjithë ofertave (në \%)}$$

FC3: Tarifat e Terminalit – maksimumi 10 pikë

Sipas paragrafit 15.1 të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, Partneri Privat ka të drejtë të vjelë Tarifat e Terminalit për Përdoruesit e Terminalit dhe ti mbajë ato gjatë Periudhës së Konkensionit, në përputhje me Skedulën 3 (*Tarifat e Terminalit*) të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

Ofertuesi duhet të ofrojë një zbritje të vetme për të aplikuar për të gjitha tarifat e terminalit të dhëna në Skedulën 3 (*Tarifat e Terminalit*) të Draft Kontratës së Konkensionit/ Partneritetit Publik Privat.

$$FC3_i = 10 \times CH_i / CH_{max}$$

ku:

$FC3_i$ = rezultati i Tarifave të Terminalit për Ofertuesin (i)

CH_i = zbritja në Tarifat e Terminalit të propozuara nga Ofertuesi (I) (në%)

CH_{max} = zbritja më e lartë në Tarifat e Terminalit të ofruara ndërmjet të gjithë ofertuesve (në%)

FC4: Ndarja e fitimit – maksimumi 10 pikë

Partneri Privat siguron Autoritetin Kontraktor me një përqindje të të ardhurave vjetore bruto.

Ofertuesit duhet të sigurojnë këtë përqindje të ndarjes së fitimit mbi të ardhurat bruto sic specifikohet në Klauzolën 13.3 të Draft Kontratës së Konkensionit/ Partneritetit Publik Privat.

$$FC4_i = 10 \times MRG_i / MRG_{max}$$

ku:

$FC4_i$ = Rezultati i Ndarjes së Fitimit për Ofertuesin (i)

MRG_i = Ndarja e fitimit e propozuar nga Ofertuesi (i) (në %)

MRG_{max} = Ndarja më e lartë e fitimit e propozuar ndërmjet të gjithë ofertuesve (në %).

FC: Rezultati Financiar – maksimumi 40 pikë

$$FC_i = FC1_i + FC2_i + FC3_i + FC4_i$$

AFATI I NDËRTIMIT

CTC1: Afati i Ndërtimit – maksimumi 10 pikë

Ofertuesit duhet të tregojnë kohën e ndërtimit (në ditë) të nevojshme nga "Data Efektive" e Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat (siç përcaktohet në Klauzolën 3.5 të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, deri në "Datën e Hapjes së Terminalit", ku kjo e fundit nënkupton datën në të cilën Terminali hapet për përdoruesit e Terminalit me objektet operative të zbatueshme në përputhje me Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

$$CTC_i = 10 \times CT_{min} / CT_i$$

ku:

CTC_i = Pikët totale për Afatin e Ndërtimit (i)

CT_i = Afati i Ndërtimit në propozim (i) (ditë)

CT_{min} = Afati më i ulët i ndërtimit në të gjithë propozimet (ditë)

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Pikët totale_i =TC_i + FC_i + CTC_i

Shtojca 12

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik i Huaj*]

VETEDEKLARIM PËR OFERTUESIT E HUAJ

Per pjesemarrjen ne proceduren per marrjen me koncesion/ppp te “_”

Date

Per:[Date]

[*Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem*] deklaroj dhe garantoj qe, ne daten e kesaj letre [*Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem*] dhe cdo anetar i *Bashkimit te Perkohshem* (kur është rasti)

- (a) nuk i eshte nenshtruar procedurave te falimentimit ose likuidimit;
- (b) nuk eshte denuar per shkelje penale;
- (c) nuk eshte denuar me Vendim te Gjykates se Formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional;
- (d) kapitalet/asetet nuk po vleresohen nga Zyra e Permbarimit apo ekziston një urdhër sekuestroje për to;
- (e) ka përmbushur të gjitha detyrimet fiskale;
- (f) ka përmbushur të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqerore .

Me respekt

Nenshkrimi i Personit te Autorizuar
Emri dhe Pozicioni i Nenshkruetit
Emri i Ofertuesit/Kryesuesit të Bashkimit të Përkohshëm
Adresa

Shtojca 13

(Shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

KRITERET TEKNIKE MINIMALE

1. Hyrje

Projekti i Terminalit duhet të përgatisë Zhvillimin e Projektit, me referencë ndaj **Zgjidhjes 3**, dhe duhet të garantojë funksionalitetin e plotë të Terminalit nëpërmjet vetëm ndërtimit dhe aktivizimit të godinave dhe ambienteve të mëposhtme :

- a) Hyrjes në Terminal me sheshrotullim në SH1 (Rruga Kastrioti);
- b) Rrugët qarkulluese të Terminalit me zbritje dhe marrje të pasagjerëve;
- c) Parkingun e autobusëve, furgona-taksi dhe taksive;
- d) Godinave të udhëtarëve;
- e) Urave të këmbësorëve;
- f) Garazhit të autobusëve dhe stacionit të shërbimit të karburantit;
- g) Hapësirës publike;
- h) Lehtësimit mjedisor.

Një listë e plotë e të gjitha përdorimeve që ofrohen në godinat e mëparshme jepet në Detyrën 4 të Përshkrimit të Projektit, gjithashtu duke iu referuar dimensioneve dhe funksioneve të godinave, e cila do të konfirmohet nga Koncesionari në projektimin e Terminalit.

2.Kriteret e përgjithshme të projektimit

Projekti i Terminalit duhet të përgatisë Përshkrimin e Projektit, me referencë të veçantë ndaj Detyrës 4, dhe duhet të konfirmojë konceptin e projektit, planin horizontal të projektit, organizimin funksional, dimensionimin, kombinimin funksional dhe sipërfaqet, aksesueshmërinë e automjeteve, rregullimin plano-altimetrikë shërbimeve, rrugët e këmbësorëve dhe pistat e automjeteve. Projektimi i Terminalit duhet të jetë në përputhje me kodet dhe/ose rregulloret kombëtare dhe kodet Europiane, gjithashtu sipas standardeve ndërkombëtare, veçanërisht për personat me lëvizshmëri të kufizuar (2008/164/EC: Vendim i Komisionit i datës 21 dhjetor 2007 në lidhje me specifikimin teknik të ndëroperueshmërisë në lidhje me personat me lëvizshmëri të kufizuar në sistemin hekurudhor konvencional dhe ekspres trans-europian, të njoftuar sipas dokumentit C(2007) 6633).

Koncesionari duhet të garantojë mundësinë e realizimit të një rruge të re hyrëse për në Terminal.

3.Kriteret e Projektimit për Godinat e udhëtarëve, Urat e Këmbësorëve.

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

Tipi dhe dimensionimi i elementëve të disa godinave (shkallët dhe parmacët, platformat hidraulike, shkallët lëvizëse, ashensorët, rrugët pa pengesa, dyert dhe hyrjet, tualetet, gjeometria e urave të këmbësorëve, daljet në raste emergjencash, informacioni vizual si sinjal drejtues, piktogramat dhe informacioni dinamik, ndriçimi, sipërfaqet e dyshemeve, ambientet e parkimit për PRM-në, pengesat transparente etj) do të duhet të jenë në përputhje me kodet europiane(2008/164/EC).

Pozicionet dhe madhësitë e godinave duhet të jenë ato të përfaqësuara në Përshkrimin e Projektit- Detyra 4.

3.1 Çështjet strukturore

Projektimi strukturor i të gjithë Terminalit duhet të respektojë udhëzimet e Kodeve Europiane si dhe të kodeve lokale, ku të dyja synohen të jenë standarde referuese.

Përveç kësaj, projektimi strukturor duhet të përmbushë kërkesat e madhësisë dhe formës të përcaktuara nga koncepti arkitekturor.

Si rrjedhojë, përdorimi i një strukture çeliku ofron më shumë hapësira dhe përshtatshmëri më të madhe në lidhje me veshjen e mureve dhe çatisë.

Gjithashtu, shpejtësia e ndërtimit, kostot e parashikueshme të mirëmbajtjes së bashku me pesha më të ulëta dhe thellësinë e ndërtimeve janë arsye të vlefshme përse struktura e çelikut është zgjidhja më e përshtatshme.

Rrjedhimisht, dyshemetë e godinave dhe platformat e urave të këmbësorëve duhet të përbëhen nga traversa të përbëra çeliku dhe pllakë hekur-betoni ndërsa themelet duhet të jenë prej betoni.

Sistemet e trajtimit mbrojtës duhet të aplikohen për kuadrot strukturore të çelikut, duke përdorur një kombinim të lyerjes, spërkatjen ose galvanizimin e metalit, në varësi të kushteve mjedisore dhe lehtësisë të mirëmbajtjes së ardhshme.

Masa projektimi si për shembull masa sizmike, termike dhe kundër zjarrit duhet të merren parasysh me fokus specifik, veçanërisht në projektimin strukturor të godinave.

Për sa i përket rezistencës ndaj tërmeteve, veprimi sizmik i parashikuar shprehet në lidhje me një probabilitet referues të tejkalimit të P_{NCR} , në një periudhë të caktuar referuese (të lidhur me kohëzgjatjen e strukturës), një periudhë referuese kthimi, T_{NCR} dhe faktorin e rëndësisë γI (për të marrë parasysh diferencimin e besueshmërisë). Vlerat e rekomanduara duhet të jenë të paktën $P_{NCR} = 10\%$ dhe $T_{NCR} = 949$ vjet.

Për më tepër, i gjithë terminali duhet të ndahet në njësi dinamike të pavarura, duke vendosur lidhje strukturore. Rrjedhimisht, sipas EuroCode 8 (Kodi European 8), vetëm një tip themeli duhet të përdoret përgjithësisht për të njëjtën strukturë, nëse kjo e fundit nuk përbëhet nga njësi dinamike të pavarura.

Së fundi, tipi dhe dimensionimi i ndërtimit do të ndikohet nga rezultatet e studimeve gjeologjike, dhe karakterizimi sizmik dhe gjeoteknik i dherave do të kryhet nga Koncesionari në zonën e projektit.

Në mënyrë të përmbledhur, sistemi strukturor duhet të përfshijë themelin në hekur-beton dhe strukturat e çelikut. Ngarkesat e projektuara për dyshemetë dhe çatitë duhet të diktohen nga kodet lokale së bashku me Kodet Europiane.

3.2 Punimet Përfundimtare të Jashtme

Projektimi i punimeve përfundimtare të jashtme duhet të diktohet nga kodet dhe/ose rregulloret kombëtare. Punimet përfundimtare të jashtme duhet të jenë me efikasitet të lartë energjie dhe të kenë kostot të ulëta mirëmbajtjeje duke përdorur vetëm materiale që nuk kërkojnë punë më pak se tetë cikle vjetore. Të gjitha materialet duhet të përzgjidhen duke marrë në konsideratë faktorë si çmimi, mirëmbajtja, fleksibiliteti dhe cilësitë akustike, qëndrueshmërinë dhe përshtatjen ndaj qëllimit. Materialet e disponueshme në nivel vendor duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur për karakteristika specifike projektimi.

Koncessionari do të përdorë punimet e mëposhtme përfundimtare të jashtme:

- Çati/ Streha metalike (veshje alumini për çati/streha me termoizolim);
- Mure metalike (veshje alumini me termoizolim);
- Dritare të gjata (trarë tërthorë alumini të nxjerrë, korniza dekorative alumini, njësi me dopjo xham, qelq me rrezatim të ulët).

Dritaret dhe dyert duhet të jenë prej elementësh të fasadave të kategorisë komerciale të cilësisë së lartë (alumin, çelik). Panelet metalike duhet të mbahen larg linjës së kategorisë për të parandaluar gërryerjen dhe kalbjen.

Me qëllim minimizimin e futjes së nxehtësisë së diellit, strehat mbi dritare do të ndihmojnë në zvogëlimin e ngarkesave të ajrit të kondicionuar (profile alumini me ndarje termike, njësi me dopjo xham, qelq me rrezatim të ulët).

Xhamat e dritareve, vitrinat me xhama dhe parrmakët duhet të jenë xhama sigurie dhe në përputhje me UNI EN ISO 12543-2.

Hapësira publike duhet të shtrohet me bazament të jashtëm betoni ose me bazament me gurë dhe gurë bordure. Sipërfaqet e bazamenteve duhet të kenë karakteristika kundër rrëshqitjes, sipas kodeve dhe rregulloreve kombëtare dhe europiane.

3.2 Punimet përfundimtare të brendshme

Hapësirat publike dhe të punonjësve duhet të ndërtohen me sipërfaqe të qëndrueshme e të forta që ulin nivelin e mirëmbajtjes, janë rezistente ndaj sulmeve vandale dhe ende ruajnë një pamje tërheqëse.

Koncessionari përdor punimet e mëposhtme përfundimtare të brendshme ose punime të tjera me të njëjtat performanca dhe pamje:

- bazamente gurësh (zonat e hyrjes, shkallët, korridoret publike, zonat e pritjes);
- dysheme/bazamente me pllaka prodhim gresi porcelani të hollë (zyra, biletari, salla teknike, dhoma zhveshjeje);
- veshje me pllaka gresi porcelani të hollë (dhomat e zhveshjes);
- vitrina me xhama dhe inoks;
- mure të suvatuara dhe të lyera (zyrë, biletari, salla teknike, dhoma zhveshjeje);
- veshje me gurë (zonat e hyrjes, shkallët);

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

- tavane me fletë alumini;
- dyert në raste zjarri (kur jepen në planin e kontrollit kundër zjarrit);
- dyer alumini.

Në zonat publike si dhe në zonat jo-publike, tavanet duhet të përmbushin kërkesat ose rregulloret e kodeve të godinave. Kur përdoren tavane të varura, duhet të sigurohet hyrja në hapësirën e tavanit.

Nëse do të përdoret panel i brendshëm prej gipsi, ai duhet të përforcohet me kuadër çeliku për të parandaluar birimin. Në ambientet e zhveshjes, ndarjet duhet të ndërtohen me punime murature.

4.Kriteret e Projektimit për Garazhin e Autobusëve

4.1 Çështje strukturore

Shihni paragrafin 3.1.

4.2 Punime përfundimtare të jashtme

Projektimi i punimeve përfundimtare të jashtme duhet të diktohet nga kodet dhe/ose rregulloret kombëtare. Punimet përfundimtare të jashtme duhet të jenë me nivel të lartë efëçence energjie dhe të ofrojnë kosto të ulëta mirëmbajtje duke përdorur vetëm materiale që nuk kërkojnë punë më pak se tetë cikle vjetore. Të gjitha materialet duhet të përzgjidhen duke marrë në konsideratë faktorë si çmimi, mirëmbajtja, fleksibiliteti dhe cilësitë akustike, qëndrueshmërinë dhe përshtatjen për qëllimin. Materialet e disponueshme në nivel lokal duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur me karakteristika specifike projektimi.

Koncesionari duhet të përdorë punimet e mëposhtme përfundimtare të jashtme:

- Streha/çati metalike (veshje alumini për strehat/çatitë me termoizolim);
- Mure metalike (veshje alumini me termoizolim);
- Dritare të gjata me ndarje të veçanta (me xham izolues dhe korniza alumini).

Dritaret dhe dyert duhet të jenë prej elementësh të fasadave të kategorisë komerciale të cilësisë së lartë (alumin, çelik). Panelet metalike duhet të mbahen larg nga linja e kategorisë për të parandaluar gërryerjen dhe kalbjen.

Xhamat e dritareve duhet të jenë xhama sigurie dhe në përputhje me UNI EN ISO 12543-2.

4.3 Punimet përfundimtare të brendshme

Koncesionari do të përdorë punimet e mëposhtme përfundimtare të brendshme ose punime të tjera me të njëjtat performanca dhe pamje:

- Mure të suvatuara dhe të lyera,
- DysHEME/bazament betoni industrial.

5. Pajisjet Mekanike

5.1 Ngrohja, ventilimi dhe ajri i kondicionuar

Sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar(HVAC) duhet të jenë me nivel të lartë efëçence energjie, të ofrojnë operim me kosto të ulët dhe të mirëmbahen lehtësisht.

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

Projektimi i sistemit HVAC do të diktohet nga kodet dhe/ose rregulloret lokale dhe standardet ndërkombëtare (NFPA), si dhe standardet teknike (ASHRAE) të referencës.

Temperatura e brendshme do të rregullohet mbi bazën e temperaturës së jashtme dhe nevojës për ruajtjen e kushteve të përshtatshme të punës për të gjithë personelin që punon në zonat e brendshme, si dhe komoditet për të gjitha kategoritë e pasagjerëve. Sistemi HVAC duhet të pajiset me zona të sistemit të rregullator.

Ventilimi mund të ofrohet duke garantuar sjelljen e ajrit në pajisjen parësore të trajtimit të ajrit. Në zonat e përgatitjes së ushqimit, ajri i sjellë i përzier i mjaftueshëm do të jetë i nevojshëm, me qëllim zëvendësimin e kapakut të shkarkimit të ajrit. Dhomat e zhveshjes do të kërkojnë sisteme të pavarura të shkarkimit të ajrit.

Do të sigurohet një sistem i integruar i menaxhimit të godinave për të kontrolluar performancën e sistemeve mekanike të Terminalit të Ri.

5.2 Punimet Hidraulike

Zonat sanitare do të pajisen nga Koncesionari me ËC (banjo) të montuara në mur, pajisje urinimi, lavamanë dhe aksesore të përshtatshëm sipas standardeve ndërkombëtare, veçanërisht për njerëzit me lëvizshmëri të kufizuar.

Furnizimi me ujë të pijshëm për instalimet hidraulike dhe konsumatorët do të sigurohet nga Koncesionari nëpërmjet një rrjeti të shpërndarjes së ujit në godina. Uji i ngrohtë do të sigurohet me bojlerë gazi ose në mënyrë alternative, me ngrohës elektrikë jo-qendrorë.

Një sistem i brendshëm i ujërave të zeza të godinave do të instalohet nga Koncesionari për të garantuar që ujërat e zeza mund të drenazhohen drejtpërdrejt në linjën e jashtme të ujërave të zeza.

5.3 Mbrojtja kundër zjarrit / Sistemi i spërkatjes nga impianti ujitës

Godina e Terminalit si një lloj i veçantë godine çon në kërkesa të veçanta për mbrojtje kundër zjarrit. Rrjedhimisht, një numër i mjaftueshëm artikujsh të pajisjeve zjarrfikëse do të sigurohet nga Koncesionari në Terminal. Terminali do të pajiset nga Koncesionari me një sistem mbrojtës impianti ujitës.

Një numër i mjaftueshëm i hidrantëve të montuar në mur dhe zjarrfikësesh do të instalohet nga Koncesionari në Terminal, i ndodhur në zona të dukshme dhe të shenjuara.

Koncesionari do të garantojë një sistem mekanik të shkarkimit të tymit në Terminal.

Sistemet e mbrojtjes kundër zjarrit plotësojnë kërkesat e NFPA Standarde Ndërkombëtare dhe rregullat lokale teknike.

Impianti i ujit për rastet e zjarreve kryesisht përbëhet nga grupe presioni qendror me pompa zjarrfikëse dhe rezervë përkatëse uji, tubacione dhe lidhje kryesore,

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

terminale shpërndarëse me zorrë dhe ulluqe, sisteme mbylljeje dhe aksesorë për mbërthimin me morsetë të tubave.

5.4 Ashensorët dhe shkallët lëvizëse

Ofrohen impiante për transportin e ngjitjes dhe uljes (ashensorë, shkallë dhe vendkalime lëvizëse) për t’i shërbyer Terminalit, në numër dhe madhësi sipas numrit të njerëzve që do të mbajnë.

Ashensorët plotësojnë standardet e kërkuara nga Standardi European UNI EN 81-1 dhe 2 rreth rregullave të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve elektrikë dhe hidraulikë.

Shkallët dhe vendkalimet lëvizëse për shërbim publik plotësojnë standardet e kërkuara nga Standardi European EN 115 rreth sigurisë së shkallëve dhe vendkalimeve lëvizëse.

6. Furnizimi me energji

Koncesionari do të bëjë të mundur ofrimin e furnizimit të besueshëm me energji elektrike për Terminalin, qendrën e operacioneve dhe të gjitha pajisjet për Terminalin dhe akomodimin e zyrave.

Koncesionari garanton që sistemet e energjisë rezervë të kenë madhësinë e duhur për të furnizuar Terminalin gjatë periudhave të ndërprerjes kryesore të energjisë. Sistemi rezervë do të projektohet për të ofruar energji shtesë në raste emergjente për ndriçim në zona publike, qendër zjarrfikëseje dhe ambiente apo shërbime të tjera kryesore për operimin e sigurt të Terminalit.

7. Furnizimi Elektrik

Terminali do të furnizohet me shpërndarjeje të voltazhit të lartë (“HV”) dhe nënstation transformatorësh për furnizimin me energji me voltazh të ulët (“LV”) (0.4 kV, 3p+Kablllo neutrale, shpërndarje me TN-S).

Furnizimi i energjisë me voltazh të lartë (“MV”) duhet të jetë në përputhje me përshkrimin e rrjeteve të jashtme elektrike.

8. Ndriçimi në ambiente të brendshme dhe të jashtme

Nivelet e ndriçimit tregohen në tabelën e mëposhtme (standardi AREMA). Këto vlera duhet të rregullohen për t’iu përshtatur kushteve, kodeve dhe/ose rregulloreve kombëtare.

Për pajisjet e ndriçimit do të përdoret burim me efikasitet të lartë energjie. Nëse lartësitë e tavaneve janë më të ulëta se 3.5 m, duhet të përdoren llamba fluoreshente ose llamba LED. Nëse lartësitë e tavaneve tejkalojnë 3.5 m, duhet të përdoren llamba HID me korrigjim ngjyre.

Zona Pritjeje	269 luks
Salla Zhveshjeje	323 luks
Shitja e Biletave	1.076 luks
Zyra Administrative e Biletarisë	1.076 luks
Korridore	215 luks
Shkallë dhe Ashensorë	215 luks
Dhomat e Personelit dhe Dhomat e Veshjes	215 luks
Salla Pritjeje për Publikun dhe Salla Ndenjeje për Punonjësit	215 luks

Garazhi dhe vendet e parkimit të tramvajeve	538 luks
---	-----------------

Koncesionari ofron ndriçim të përshtatshëm në Terminal, me qëllim shfrytëzimin e këtij terminali për komoditet vizual dhe të këndshëm për pasagjerët.

Koncesionari ofron pajisje orientuese për të ndihmuar përdoruesit e terminalit që të njohin destinacionet dhe rrugët drejt hyrjeve dhe daljeve, si dhe ambiente apo shërbime specifike. Ndihma orientuese do të jepet nga një sistem lehtësisht i kuptueshëm dhe i dallueshëm i temperaturave të ndryshme të dritës të përdorura për të theksuar zona të veçanta të lartpërmendura.

Nga hyrja e aksesueshme e godinës për në pikën e hyrjes në platformë, rruga pa pengesa do të ndriçohet me një nivel minimal ndriçimi prej 100 luks, e matur në nivel dyshemeje, brenda kufijve të godinave të Terminalit. Niveli minimal i kërkuar i ndriçimit në hyrjen kryesore, shkallë dhe në fund të platformave hidraulike, duhet të jetë 100 luks matur në nivel dyshemeje. Nëse ndriçimi artificial kërkohet për arritjen e këtij qëllimi, niveli i kërkuar i ndriçimit do të jetë minimalisht 40 luks mbi nivelet e ndriçimit të ambientit rrethues, dhe kanë një temperaturë më të ulët ngjyre.

Platformat dhe zona të tjera të jashtme pasagjerësh në godina duhet të kenë një nivel minimal mesatar ndriçimi prej 20 luks matur në nivel dyshemeje, me vlerë minimale 10 luks.

Nëse kërkohet ndriçim artificial për të mundësuar leximin e informacionit të detajuar, këto vendndodhje duhet të theksohen me ndriçim me rritje minimale 15 luks mbi atë të ofruar në zonat përreth. Kjo rritje ndriçimi duhet të ketë gjithashtu një temperaturë të ndryshme ngjyre me atë në zonat përreth.

Ndriçimi në raste emergjente duhet të jetë në përputhje me Rregullat Europiane ose Kombëtare.

8.1 Ndriçimi i Rrugëve

Projektimi i ndriçimit të rrugëve brenda Terminalit duhet të garantojë kërkesat minimale të përcaktuara nga Standardi UNI 10439:2001 –Kërkesat teknologjike të ndriçimit të rrugëve për trafikun e mjeteve motorike (kategoria 1 E, Rrugët urbane të Rrethit).

Kategoria 1	Tipi i rrugës dhe zonës territoriale	Indeksi i kategorisë së ndriçimit
E	Rrugët urbane të Rrethit	4

Indeksi i kategorisë së ndriçimit	Vlera minimale e ndriçimit të shfrytëzuar mesatar L_m cd/metër katror.	Uniformiteti Minimal		Indeksi i shkëlqimit të zbehur TI 3)
		$U_{0.1}$	$U_{1.2}$	
		%	%	
4	1,0	40	50	10

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

- i. U_0 = raporti L_{min}/L mesat. midis ndriçimit minimal dhe mesatar në të gjithë gjatësinë e rrugës
- ii. U_1 = raporti L_{min}/L mesat. midis ndriçimit minimal dhe maksimal përgjatë vijës qendrore të secilës kors
- iii. TI = indeksi i shkëlqimit të zbehur

Ndriçimi i rrugëve sigurohet nga Koncesionari për:

1. Sheshrrotullimin e Terminalit të specifikuar në Përshkrimin e Projektit,
2. Rrugën qarkulluese të Terminalit.

Për këtë ndriçim rrugor dritat artificiale tipike për instalimin e jashtëm nuk duhet të jenë me energji, lartësi dhe frekuencë më të ulët sesa ato të përcaktuara më poshtë.

a) *Sheshrrotullimi i Terminalit:*

- Shtyllë 12 m e lartë me katër Projektorë me Sodium me Presion të Lartë 400 Ë.

b) *Rruga qarkulluese e Terminalit:*

- Dritat artificiale të rrugëve dhe shtylla 300 Ë, 10 m e lartë dhe me ndarje hapësirash 50 m

c) *Vendet e Parkimit:*

- Dritat artificiale të rrugëve dhe shtylla 300 Ë, 10 m e lartë dhe me ndarje hapësirash 50 m.

Këto instalime/pajisje ndriçimi duhet të sigurohen për çdo rrugë me dy kors, siç përcaktohet hollësisht, vetëm në një anë të rrugës.

9. Sistemet Telefonike/Intercom

Një sistem telefonik/intercom do të ofrohet për Terminalin. Centrali i degës private për të gjithë Terminalin mund të vendoset në Terminal.

10. Të dhënat dhe sisteme të veçanta

Një rrjet i strukturuar kabllor do të ofrohet për Terminalin, duke filluar nga komunikimet qendrore MDB brenda ambienteve të zyrave të terminalit. Pajisjet qendrore të sistemeve të mëposhtme do të kenë vendndodhje në sallën kryesore të komunikimit dhe do të shpërndahen nëpërmjet rrjetit të strukturuar kabllor, në rastet kur është e zbatueshme. Duhet të ofrohen të gjithë komponentët e nevojshëm aktivë të sistemit si serveri, ruteri, nyjat, urat dhe komponentë të tjerë të ngjashëm.

11. Sistemet e sigurisë

Për qëllime mbikëqyrjeje, kamera Televizive me Qark të Mbyllur (CCTV) dhe monitorë për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme dhe një sistem automatik i godinave (BAS) duhet të ofrohet dhe të jetë operacional 24 orë në ditë brenda një salle kontrolli.

12. Sinjalistika

Brenda terminalit do të ndodhet një sistem sinjalistike për udhëtarët, i cili përbëhet nga një stendë informacioni për secilin vend parkimi autobusësh (tekst me dy rreshta që tregon oraret, numrin e vendeve të parkimit dhe destinacionin) dhe dy ekrane gjigande (100 inç), me karaktere 5 cm të lartë dhe të dukshme deri në 30 metra, me 60 rreshta.

13. Sistemet informative të autobusëve

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

Sistemet e adresave publike duhet të ofrohen për kryerjen e njoftimeve të nisjeve dhe mbërritjeve të autobusëve. Altoparlantët duhet të jenë të tipeve me energji të ulët, me ndarje të vogla hapësirash me qëllim të zvogëlimit të jehonave.

Vendndodhjet e mikrofonave duhet të jenë në sportelin e biletarisë, sportelin e informacionit dhe në zonat e hipjes/bordingut. Nëse ndërtohet një numër i madh platformash, duhet të merret në konsideratë ndarja zonale e sistemit të PA-së për të mundësuar njoftimet e synuara.

Shfaqja e informacionit mbi nisjen dhe mbërritjen e autobusëve duhet të kryhet me anë të përdorimit të stendave/tabelave të njoftimeve ose njësive me ekrane video (CRTs).

14. Shërbimet Publike

14.1 Furnizimi me Ujë

Koncesionari është përgjegjës për ofrimin e furnizimit me ujë për plotësimin e kërkesave në Terminal.

Koncesionari do të sigurojë furnizim të mjaftueshëm me ujë të pijshëm për Terminalin dhe ambientet e zyrave, së bashku me ofrimin dhe ruajtjen e ujit të pijshëm dhe ujit të mjaftueshëm për masat kundër zjarrit, zjarrfikëset dhe ujitjen.

14.2 Sistemi i Furnizimit me Ujë

Puse të reja do të shpohen në vendin e Terminalit nga Koncesionari, me qëllim ofrimin e ujit të mjaftueshëm për kërkesat në rritje të pasagjerëve, vizitorëve dhe furnizimit ushqimor.

Furnizimi me ujë për zjarrfikësen ofrohet nga një rezervuar uji që do të zgjerohet sipas nevojave gjatë Periudhës së Koncesionit, duke marrë parasysh nivelet e trafikut dhe automatet që përdorin Terminalin.

14.3 Sistemi i Ujit të Pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm i ofruar nga Koncesionari do të jetë i aftë të mbulojë kërkesën totale të Terminalit.

Një stacion përforcues duhet të përfshijë (por jo të kufizohet) tek një rezervuar me ujë të pastër për balancimin e kërkesave, sallë kontrolli (përfshirë një sallë monitorimi) dhe të gjitha pajisjet e kërkuara elektrike dhe mekanike për operimin e rregullimit të presionit me materiale rezervë për dublikimin e sistemit. Do të instalohet një gjenerator si sistem dytësor i furnizimit me energji, me kapacitet të mjaftueshëm për stacionin përforcues të ujit të pijshëm.

14.4 Ujërat e Zeza

Koncesionari do të ofrojë, operojë dhe mirëmbajë gjatë Periudhës së Koncesionit një impiant për trajtimin e ujërave të zeza në Terminal për trajtimin e të gjitha ujërave të zeza përpara se të shkarkohet në rrjetin lokal të ujërave të zeza.

Nën sheshin e terminalit do të ketë një sistem për kullimin e reshjeve, i cili do të shpërndajë ujin në nëntokë ose do të akumulohet para zbrazjes në rrjetin lokal të ujërave të zeza me rrjedhë të rregulluar.

Impianti i trajtimit të ujërave të zeza duhet të jetë në përputhje me Ligjet e Zbatueshme dhe duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm për kapacitetin maksimal të projektimit të Terminalit.

14.5 Sistemi i Ujërave të Zeza

Sistemi i ujërave të zeza duhet të krijohet nga Koncesionari si një sistem i plotë, i veçantë për ujërat e zeza pa lidhje drenazhimi të ujit sipërfaqësor.

Ky sistem i ujërave të zeza duhet të grumbullojë ujërat e zeza të Terminalit. Të gjitha ambientet e sapondërtuara të Terminalit duhet të lidhen me sistemin. Ujërat e zeza të grumbulluara do të drenazhohen më pas për në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza të Terminalit, të ofruar nga Koncesionari.

14.6 Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza të Terminalit

Impianti i trajtimit të ujërave të zeza i ofruar nga Koncesionari do të trajtojë, në përgjithësi, ujërat e zeza të Terminalit. Pa lidhje me drenazhimin e ujërave sipërfaqësore.

14.7 Telekomunikimet

Koncesionari është përgjegjës për instalimin e sistemeve përkatëse të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit brenda Zonës së Koncesionit, për t'i shërbyer nevojave të Terminalit.

15. Kriteret e Projektimit për sheshrrotullimin e Terminalit, Rrugët Qarkulluese të Terminalit dhe Parkimin e Autobusëve

15.1 Kriteret e Projektimit të Strukturës së Trotuarit

Trotuari duhet të projektohet me anë të përdorimit të standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare për të garantuar qëndrueshmëri në të gjithë Shtetin dhe për të ofruar një strukturë trotuari që do të ketë rezistencë të mjaftueshme, cilësi kalimi dhe qëndrueshmëri për mbajtjen e ngarkesave të parashikuara të trafikut për kohëzgjatjen e projektimit.

Struktura përfundimtare e trotuarit duhet të bazohet në një shqyrtim të plotë të kushteve specifike të projektit, duke përfshirë dherat e nënshtresës dhe materialet strukturore, kushtet mjedisore, trafikun e parashikuar, efektivitetin e kostos dhe performancën e trotuareve të tjerë në të njëjtën zonë ose në kushte të ngjashme klimatike dhe të trafikut.

Rrjedhimisht, si rekomandim, shtresat e strukturave të trotuareve të rrugëve dhe hapësirave të parkimit duhet të projektohen duke respektuar AASHTO “Udhëzimet për Projektimin e Strukturave të Trotuareve” që do të konsiderohen si udhërrëfyes.

Në veçanti, në lidhje me të dhënat e dërguara të metodës projektuese empirike-statistikore AASHTO, PSI_t (Indeksi Fillestar i Kapacitetit Ofrues të Shërbimeve) duhet të konsiderohet i barabartë me 4,2 dhe PSI_t (Indeksi Përfundimtar i Kapacitetit Ofrues të Shërbimeve) i barabartë me 2,5, me besueshmëri të paktën $R=90\%$.

Përveç kësaj, Koncesionari duhet të llogarisë ESAL-të e projektimit (ngarkesat boshtore standarde të barazvlefshme), duke marrë në konsideratë ato volume të përditshme trafiku të llogaritura në paragrafin 5.1 të Studimit të Fizibilitetit

Detyra 4 dhe gjithashtu duke analizuar të paktën kohëzgjatjen 20 vjeçare të projektimit të trotuarit.

Megjithatë, për sa i përket një trotuari fleksibël, karakteristikave të shtresave strukturore si për shembull cilësitë dhe trashësia e materialeve, duhet të respektojnë të paktën standardet e mëposhtme minimale të renditura më poshtë nga lart poshtë:

- Shtresa e sipërme (e njohur edhe si shtresa sipërfaqësore) e përbërë nga asfalto-beton 4 cm;
- Shtresa lidhëse (e njohur edhe si shtresa bazë) e përbërë nga asfalto-beton 8cm;
- Baza (e njohur edhe si baza e rrugës) e përbërë nga asfalto-beton 10 cm;
- Shtresa e nënbazës e përbërë nga materiale për beton të ngjeshura dhe të stabilizuara 25cm;
- Shtresë e ndërmjetme e përbërë nga rërë e palidhur 20 cm dhe zhavorr me trashësi.

15.2 Dimensioni dhe gjeometria e Sheshrrrotullimit, Rrugëve Qarkulluese dhe Parkimit të autobusëve

Koncesionari duhet të projektojë Sheshrrrotullimin dhe Rrugët Qarkulluese të Terminalit sipas Përshkrimit të Projektit- Detyra 4.

Koncesionari duhet të përcaktojë madhësinë e parkimit të autobusëve sipas Përshkrimit të Projektit- Detyra 4.

15.3 Zonat e Parkimit

Sipas zonave të parkimit Koncesionari do të ofrojë një sistem drenazhimi të reshjeve që do të shpërndajë ujin në nëntokë ose do ta akumulojë atë. Përpara se të zbrazet në rrjetin lokal të ujërave të zeza me rrjedhë të rregulluar, uji do të trajtohet nëpërmjet një ndarësi vaji.

15.4 Platformat

Dimensionimi: madhësia e platformave duhet të projektohet në përputhje me Përshkrimin e Projektit- Detyra 4.

Punimet përfundimtare: platformat do të shtrohen në asfalt me gurë bordurash prej betoni.

15.5 Strehat/çatitë e platformave

Për çështje strukturore, shihni paragrafin 3.1.Sistemi strukturor i strehave/çatitë të platformave përfshin themele në strukturat prej çeliku dhe hekur-beton.

Punimet përfundimtare: strehat/çatitë do të përbëhen nga veshje metalike (veshje alumini për çatitë, me termoizolim).

15.6 Kontrolli i Aksesit Automatik

Koncesionari do të ofrojë një kontroll të aksesit automatik që ka dy porta, një hyrëse dhe një dalje nga terminali që përbëhen minimalisht nga 2 shtylla, 2 barriera, 4 bobina elektromagnetike, një bankomat, 1 panel "të plotë", si dhe aparatet (hardueri dhe softueri) për menaxhimin e pajisjeve.

16. Auditimet përkatëse të Rasteve kundër Zjarrit dhe Shpëtimit prej tij

16.1 Pajisjet/Shërbimet kundër Zjarrit dhe Shpëtimit

Koncesionari ofron pajisje/shërbime kundër zjarrit dhe shpëtimit, në përputhje të plotë me standardet përkatëse.

Koncesionari do të projektojë, ofrojë dhe mirëmbajë pajisjet/shërbimet zjarrfikëse për shërbimet zjarrfikëse dhe të shpëtimit të Terminalit.

Koncesionari do të projektojë një Plan Emergjencash dhe Evakuimi.

16.2 Shërbimi i sigurisë i zjarrfikëseve

Koncesionari do të ofrojë një sallë për shërbimin e sigurisë të zjarrfikëseve (salla e kontrollit).

16.3 Auditime për Rastet e Zjarreve dhe Shpëtimit prej tij

Koncesionari do të garantojë që një nëpunës sigurie dhe sigurimi do të kryejë auditime të rregullta të shërbimeve zjarrfikëse në Terminal ndërsa rezultatet e këtyre auditimeve do t'i jepen sipas kërkesës, Subjektit Shtetëror përkatës.

Në çdo kohë Koncesionari do të përmirësojë procedurat e emergjencës të Terminalit, duke garantuar mjaftueshmërinë e daljeve në raste zjarri dhe sinjalistikës menjëherë pas vlerësimit të duhur të këtyre procedurave.

17. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë të Terminalit

Koncesionari duhet të përgatisë sistemin e menaxhimit të sigurisë të Terminalit që duhet të përfshijë elementët e mëposhtëm:

- Dokumentacionin e sigurisë në lidhje me procedurat e brendshme të sigurisë.
- Mbledhjen e të dhënave dhe sistemin e raportimit në lidhje me të gjitha aspektet e sigurisë
- Vlerësimin e të dhënave të Terminalit dhe përcaktimin e tendencave.
- Masat e rekomanduara të sigurisë
- Legjislacionin për sigurinë profesionale dhe ligjin mbi shëndetin sipas direktivave të Bashkimit Europian.

Koncesionari garanton se të gjithë Përdoruesit e Terminalit veprojnë në përputhje me kërkesat e specifikuar të sigurisë.

Të gjithë Përdoruesit e Terminalit kërkohen nga Koncesionari që të veprojnë në përputhje me kërkesat e sigurisë.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë në Terminal duhet t'i nënshtrohet rishikimeve dhe përditësimeve vjetore nga Koncesionari, për të garantuar përputhshmërinë me standardet dhe praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare.

18. Mirëmbajtja e Terminalit

Koncesionari mund të nënkontrakttojë aktivitete rutinë dhe korrigjuese mirëmbajtjeje për një organizatë palë të tretë. Koncesionari do të garantojë që të arrihen standardet e mëposhtme në lidhje me të dyja tipet e mirëmbajtjes të përcaktuara hollësisht më poshtë:

1. Mirëmbajtja e planifikuar parandaluese

Koncesionari duhet të caktojë intervale të planifikuara mirëmbajtjeje në bazë të rekomandimeve dhe standardeve të specifikuara nga prodhuesit individual, për të garantuar disponueshmërinë dhe besueshmërinë e kërkuar të sistemit. Nëse është e mundur, mirëmbajtja e planifikuar duhet të kryhet gjatë periudhave jo-funksionale ose me trafik të ulët, me qëllim minimizimin e ndikimit ndaj operacioneve të Terminalit.

2. Mirëmbajtja për qëllime korrigjimi dhe në raste emergjencash

Për ato sisteme që karakterizohen si kritike për operimin e Terminalit dhe që kanë një kohë reagimi më pak se gjysmë ore, Kontraktori i mirëmbajtjes duhet të ofrojë mbulim në vendpunim deri në 24 orë.

Për sistemet jo-kritike, me një kohë reagimi prej më shumë se gjysmë orë, Kontraktori i mirëmbajtjes do të ofrojë mbulim deri në 24 orë por mbi bazën e "kërkesave".

Nëse është e mundur, koha mesatare për riparim duhet të jetë dy orë.

Mbajtja e pjesëve të këmbimit të pajisjeve duhet t'i nënshtrohet rishikimeve për të garantuar përputhshmërinë me kriteret e mësipërme.

18.1 Mirëmbajtja dhe inspektimet e Terminalit

Sistemi i inspektimit duhet të garantojë që të gjitha defektet në ambientet fizike të raportohen dhe korrigjohen brenda një kohe të shpejtë, kur kërkohet, si dhe çdo avari, mosdisponueshmëri shërbimi ose pengesë që mund të cenojë sigurinë e Terminalit dhe personelin.

19. Menaxhimi Mjedisor

Plani i Menaxhimit Mjedisor (**PMM**) për zhvillimin e projekteve zakonisht përfshin ofrimin e një kuadri logjik brenda të cilit ka ndikimet e identifikuara negative mjedisore mund të lehtësohen dhe monitorohen.

Koncesionari përgatit planin e menaxhimit mjedisor ("**PMM**") që trajton të gjitha çështjet mjedisore në faza të ndryshme të zhvillimit të projektit brenda Zonës së Koncesionit dhe garanton përputhshmëri me këtë PMM si më poshtë:

1. Cilësia e ajrit

- Të marrë përsipër monitorimin para ndërtimit të cilësisë ekzistuese të ajrit të ambientit;
- Të hartojë Planin e Menaxhimit të Pluhurave dhe Cilësisë së Ajrit, i cili duhet të përfshijë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për të minimizuar formimin e pluhurit dhe ulur emetimet nga aktivitete të tilla si ndërtimi, transporti dhe lëvizshmëria;
- Të garantojë se vlerësimi i kushteve teknike të automjeteve në lidhje me ndikimin e emetimeve nga ndotja e ajrit është pjesë integrale e procesit të inspektimit teknik të automjeteve, i rregulluar nga legjislacioni përkatës;
- Të garantojë se lëndët djegëse kimike, vajrat, kimikatet dhe depozitimet e substancave të tjera të dëmshme do të ruhen mbi një bazë të papërshekueshme nga uji të mbrojtur nga një argjinaturë me kapacitet të barabartë me 110% të kapacitetit ruajtës të serbatorit më të madh;
- Të monitorojë cilësinë e ajrit të ambientit në një stacion monitorues të cilësisë së ajrit që operon në mënyrë të vazhdueshme, për matjen e

përqendrimeve të ajrit të ambientit dhe për përcaktimin nëse standardet e cilësisë së ajrit të ambientit janë duke u tejkaluar;

- Të bashkëpunojë me autoritetet bashkiake të trafikut (Qendra e Kontrollit të Trafikut, Tiranë (QKTT)) për të projektuar dhe zhvilluar menaxhimin e trafikut dhe iniciativa të tjera për inkurajimin e drejtuesve të mjeteve për minimizimin e emetimeve;
- Të projektojë stacionin e karburantit, rreptësisht në përputhje me Kodin për projektimin dhe ndërtimin e stacionit të mbushjes me gaz dhe gazolinën e automobilave. Funksionimi i stacionit të karburantit duhet të respektojë rreptësisht kërkesat sipas kërkesave të Sigurisë për Funksionimin e Stacioneve të Karburantit; dhe
- Të prezantojë një program vjetor të monitorimit të cilësisë së ajrit.

2. Cilësia e Ujit

- Të përgatisë dhe aplikojë një protokoll për trajtimin e materialeve të ndërtimit;
- Të menaxhojë në mënyrë efektive dorëzimin dhe ruajtjen e materialeve të ndërtimit, larg masave ujore dhe zonave ku ndikimet e rrjedhjeve ose shkarkimeve mund të jenë minimale;
- Të garantojë grumbullimin dhe trajtimin në mënyrë të ndarë të ujërave të zeza nga punëtorët e ndërtimit, mensat etj.
- Të garantojë grumbullimin e ujit nga zona e furnizimit me lëndë djegëse dhe të lidhet me ndarësin e ujit nga vaji. Duhet të instalohen absorbentët e vajit/naftës dhe pajisje të tjera të nevojshme reaguese për derdhje.

3. Zvogëlimi i Zhurmave

- Të hartojë një Studim të detajuar të Zhurmave të Trafikut gjatë zhvillimit të projektimit të detajuar për të identifikuar dhe parashikuar nivelet e zhurmave nga trafiku në receptorët sensitivë dhe për të përcaktuar masat optimale të zbutjes së zhurmave për arritjen e përputhshmërisë me standardet përkatëse;
- Të krijojë një Program Monitorimi për matjen e niveleve të zhurmave nga ndërtimi në receptorët sensitivë më të afërt ndërsa puna fillon në çdo seksion të ri përgjatë rrugës;
- Të garantojë se pajisjet e ndërtimit do të plotësojnë standardet shqiptare dhe evropiane për emetimin e tingujve të pajisjeve që funksionojnë në ambiente të jashtme, kur është e zbatueshme dhe e përshtatshme;
- Të garantojë shmangien e aktiviteteve që gjenerojnë zhurma gjatë natës dhe të performojë vetëm kur është e rëndësishme dhe në përputhje me një leje të posaçme të marrë për këtë qëllim nga autoriteti përkatës;
- Të garantojë barriera të përkohshme për zhurmat në vende të përshtatshme, për zvogëlimin e ndikimeve të zhurmave. Këto zona duhet të përfshijnë makineri të fiksuara për zhurmat dhe/ose zona me receptorë sensitivë, bazuar në rezultatet e monitorimit të nivelit të zhurmave në terren, dhe
- Komunikimi me banorët që jetojnë brenda zonave potencialisht të prekura, dhe konsultimet e vazhdueshme në lidhje me shqetësimet, vështirësitë dhe sugjerimet e tyre për kontrollin e zhurmës përpara fillimit të ndërtimit gjatë natës. Këto probleme do të zgjidhen dhe do të merren sugjerime, sipas rastit.

4. Zvogëlimi i vibrimeve

- Të kryejë monitorimin e vibrimit me fillimin e aktiviteteve përkatëse, për të garantuar mos-tejkalimin e kufijve për vibrim. Nëse ato tejkalohen, duhet të merren masa për uljen e vibrimit;
- Të identifikojë vendndodhje të tilla si shkolla, spitale, të cilat mund të përmbajnë pajisje sensitive ndaj vibrimit dhe të zhvillojë diskutime me institucionet përkatëse për të garantuar se ndërtimi menaxhohet për shmangien e ndikimeve të dëmshme në përdorimin e pajisjeve

5. Menaxhimi i Mbetjeve

- Të hartojë një Plan për Menaxhimin e Mbetjeve (PMM) të pajtueshëm me praktikën më të mirë ndërkombëtare, Direktivën Kuadër të BE-së për Mbetjet dhe rregulloren përkatëse shqiptare dhe mbulimin e të gjitha tipeve të mbetjeve ndërtimore.
- Të krijojë një sistem për menaxhimin e mbetjeve në sheshet e ndërtimit, mbetjet e ndërtimit dhe shkatërrimit, dheun e gërmuar, duke përfshirë mbetjet e rrezikshme mbi bazën e praktikës më të mirë ndërkombëtare;
- Të garantojë që dokumentacioni për kontratat e punimeve civile të përfshijë kërkesa specifike për parandalimin e erozionit të dheut dhe përcaktimin e përgjegjësive të Kontraktorve.
- Të garantojë që mbetjet e ngurta grumbullohen dhe ruhen në vend në përputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor në kontejnerë me madhësi dhe dizeno të përshtatshme që duhet të sigurohen për ruajtje të sigurt dhe ndarje të të gjitha mbetjeve.
- Të hartojë një Plan për Menaxhimin e Materialeve të Rrezikshme të zbatueshëm për të gjithë nënKontraktorit dhe në përputhje me rregulloret shqiptare dhe kërkesat e BE-së dhe që duhet të miratohet nga Organizata Mbikëqyrëse.
- Të garantojë që përzgjedhja, ruajtja, përdorimi dhe asgjësimi i materialeve të rrezikshme do të kontrollohet rreptësisht gjatë ndërtimit në përputhje me kërkesat përkatëse kombëtare dhe të BE-së në lidhje me shëndetin e punëtorëve dhe sigurinë dhe mbrojtjen mjedisore, si dhe praktikën e mirë të industrisë.
- Të marrë masa operacionale për të gjitha aspektet nga shmangia e mbetjeve, zvogëlimi, riciklimi, ripërdorimi deri tek grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve; dhe
- Të garantojë se të dhëna të plota mbahen për tipin, sasinë, përbërjen, origjinën, asgjësimin, destinacionin dhe metodën e transportit për të gjitha mbetjet.

6. Mjedisi ekologjik

- Të miratojë praktikën e mirë të sheshit të ndërtimit për mbrojtjen e dherave dhe të ndjekë udhëzimet shqiptare dhe të shmangë gërmimin dhe mbushjen në sezonin e shirave, dhe
- Të realizojë një pemë të detajuar për të përcaktuar specien, moshën, lartësinë dhe gjendjen e të gjitha pemëve që do të priten dhe ky informacion do të përdoret për planifikimin e mbjelljeve zëvendësuese.

7. Rreziku nga tërmeti

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

-Të kryejë sondazhe dhe studime në terren për vlerësimin e rreziqeve nga tërmetet, përmytjet dhe erozioni;

-Të kryejë studime të mëtejshme për vlerësimin e rrezikut nga lëngështimi i tokës (nga tërmetet); dhe

Të garantojë se Projekti do të projektohet dhe ndërtohet për trajtimin e këtyre rreziqeve.

8. Planifikimi dhe reagimi në raste emergjencash

-Të përgatisë një Plan për Reagimin dhe Gatishmërinë në Raste Emergjencash për funksionimin e terminalit për trajtimin e të gjitha incidenteve të parashikueshme, duke përfshirë zjarrin, shpërthimin, aksidentet rrugore, tërmetin dhe rreziqe të tjera. Plani duhet të shqyrtojë kufizimet ndaj materialeve, për shembull lëndë plasëse, gaze etj.

-Të përgatisë planin në konsultim me shërbimet lokale të emergjencave dhe të përfshijë planet për parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave që prekin përdoruesit rrugorë (automjete dhe këmbësorë) dhe komunitetin. I gjithë informacioni i nevojshëm do t'i transmetohet përdoruesve rrugorë dhe komunitetit më të gjerë; dhe

-Të ndërmarrë një auditim për sigurinë rrugore nga një palë e tretë e kualifikuar e pavarur. Godina e Operacioneve duhet të projektohet për të përfshirë një sallë për ekipin e emergjencave dhe pajisjet përkatëse.

9. Manuali i Mbikëqyrjes dhe Operimit Mjedisor

- Përgatitja e një manuali të mbikëqyrjes dhe operimit mjedisor nga Kontraktorit për miratim nga Ministria e Transportit.

10. Zyra e Informacionit dhe e Ankesave

- Të krijojë një Zyrë Informacioni dhe Ankesash me personel të mirë-trajnuar, të aftë për trajtimin e ankesave, krizave ose konflikteve me banorët për shkak të problemeve nga ndikimet mjedisore.

11. Zhvendosja e shërbimeve publike

- Kryerja e përgatitjeve të plota dhe zhvillimi i studimeve në bashkëpunim me departamentet përkatëse;
- Duhet të krijohen skema të menaxhimit të trafikut; duhet të analizohen emergjenca të mundshme dhe masa lehtësuese.

12. Zbulimi dhe konsultimi i informacionit

- Të përgatisë informacion publik me rrugë të gjerë dhe skemë edukimi për informimin e komunitetit lokal si pjesë e PAGI-t (Planit të Angazhimit të Grupeve të Interesit).
- Të kryejë konsultime publike me banorët vendas për t'i informuar për aktivitetet e projektit dhe për marrjen e komenteve. Duhet të ndërtohen rrugë hyrëse të përkohshme para bllokimit të rrugëve të ndërtimit.
- Afishe/stenda informative, oraret e ndërtimit, linja telefonike për komentet dhe ankesat duhet të instalohen në sheshet e ndërtimit.

13. Bashkëpunim me Subjektet Shtetërore për monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit brenda Zonës së Koncesionit.

14. Prezantim i standardeve mjedisore që duhet të respektohen nga të gjithë personat që operojnë brenda Zonës së Koncesionit.

15. Prezantim i planit të menaxhimit mjedisor për të verifikuar parashikimin e vlerësimit të ndikimeve mjedisore dhe për të përcaktuar performancën mjedisore dhe ndikimet në zonën përreth.

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

16. Përgatitje e një regjistri ligjor për leje dhe aprovime të lidhura me aspekte operacionale, mjedisore dhe arkitekurore/projektimin.

17. Nxitje e ndërgjegjësimit mjedisor tek publiku i gjerë.

Zbatimi i PMM-së dhe rezultatet duhet të publikohen çdo vit nga Koncesionari në raportin mjedisor.

Realizimi dhe zbatimi i planit të menaxhimit mjedisor duhet të jetë në përputhje me kërkesat e brendshme rregullatore, kërkesat ndërkombëtare, praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe Kërkesat e Huadhënësve.

OBJEKTI I PROJEKTIT

Objekti i projektit përshkruhet si “Zgjidhja 3” në dokumentin "Përshkrimi i Projektit" (zgjidhja pa parking nëntokësor) me përjashtim të godinave të mëposhtme:

- a) Qendra tregtare dhe kulturore;
- b) Kulla me ambiente zyresh, hotel dhe salla konferencash;
- c) Parkingu i makinave me shumë nivele;
- d) Motel;
- e) Stacioni i trenave-tramvajeve;
- f) Magazina e tramvajeve.

Projektimi i Terminalit duhet të garantojë funksionalitetin e plotë të Terminalit nëpërmjet vetëm ndërtimit dhe aktivizimit të godinave dhe ambienteve të mëposhtme:

1. Hyrjes në Terminal me sheshrrrotullim në SH1 (Ruga Kastrioti);
2. Rrugët qarkulluese të Terminalit me zbritjen dhe marrjeve e pasagjerëve;
3. Parkingu e autobusëve, furgona-taksi dhe taksive;
4. Godinave të udhëtarëve;
5. Urave të këmbësorëve;
6. Garazhit të autobusëve dhe stacionit të shërbimit të karburantit;
7. Hapësirës publike;
8. Lehtësimit mjedisor.

Një listë e plotë e të gjitha përdorimeve në godinat e përfshira në Detyrën 4 ndodhet në Zgjidhjen 3 të Përshkrimit të Projektit.

Shtojca 14

(Shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Shtojca 15

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të koncesionit/partneritetit publik privat. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s’kualifikuat] për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme

Nëse mendoni se, Autoriteti Kontraktor ka shkelur Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM nr.575, date 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik
Tiranë”

vlërësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, gjatë procedurës së koncesionit/ppp, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Ligjin “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” .

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të koncesionit/ppp-ve.

Me respekt

< **Emri** >

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Shtojca 16

[*Shtojce per tu plotesuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. _____ Vlera *(me numra dhe fjale)* _____

2. _____ Vlera *(me numra dhe fjale)* _____

Etj. _____ Vlera *(me numra dhe fjale)* _____

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. _____

2. _____

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

* * *

(Autoriteti Kontraktues) lajmëron *[emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]* se oferta e paraqitur më datë *[data]* për marrjen me koncesion te *[emri dhe përshkrimi i përgjithshëm i objektit te kontrates]* është pranuar.

Afati i negociimit te Kontrates tuaj do te jete _____

Ofertuesi *[emri]* kërkohet t’i paraqesë (Autoriteti Kontraktues) dokumentet e meposhtme:

- Kopjen e vënies në dijëni për Formularin e Kushteve te Pergjithshme dhe te Vecanta te Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

- Sigurimin e Kontrates sipas formes se kerkuar ne Dokumentat Standarte te Procedures Konkurruese. Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nenshkrimit te Kontrates nga te dy palet.
- Dokument bankar qe verteton pagesen e kryer per shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulences se specializuar (*ne rast se ka*). Kjo pagese do te kryhet para fillimit te negociatave.
- Ne rast se, terhiqeni nga lidhja e kontrates duhet te njoftoni me shkrim.

..... *Autoriteti kontraktues*

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor]

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të koncesionit/partneritetit publik privat.
- 1.2 Ligji për koncesionet/partneritetin publik privat në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat ekonkesionit/partneritetit publik privat. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Afati i realizimit të punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokures.
- 2.3 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese,
- 2.4 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.5 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

- 2.6 “Data e fillimit” është përfshirë në të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndërtimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.7 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantiere për realizimin e ndërtimeve.
- 2.8 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.9 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.10 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.11 “Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.12 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.13 “Kantieri” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.14 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.15 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.16 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.17 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartzimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.18 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.19 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtëkoncesion/partneritet publik privat.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Komunikimi

- 8.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 9: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 9.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 10: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 10.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 11: Kontraktori që Kryen Punimet

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

11.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

11.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

11.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 12: Ekzekutimi i Punimeve

12.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 13: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

13.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

13.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 14: Zbulimet

14.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë autoritetin kontraktor për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 15: Disponimi i Kantierit

15.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 16: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

16.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 17: Forca Madhore

17.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

17.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

17.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere autoritetin kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 18: Negociatat dhe Amendamentet

18.1 Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.

18.2 Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti kontraktues dhe koncesionari /partneri privat.

18.3 Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;

b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;

c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;

ç) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve, ose në realizimin e kontratës.

18.4 Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

18.5 Pa shkelur dispozitat e neneve 32 dhe 33, të ligjit për koncesionet dhe partneritetin public privat termi “kushtet thelbësore” u referohen në veçanti kushteve të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.

18.6 Autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha ndryshimet e planifikuara, të cilat ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit direkt ose indirekt në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e organeve vendore apo të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare siç përcaktohet nga ky ligj.

18.7 Autoriteti kontraktues njofton jo më vonë se 20 ditë Ministrinë e Financave për ndryshimet e bëra në kontratë në përputhje me këtë nen.

Neni 19: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

19.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

19.2 Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 20: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

20.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t’i shërbyer sa më mirë interesit publik.

20.2 Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

20.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t’i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 21: Nënkontraktimi

21.1 Autoriteti kontraktues mund:

a) t’i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30% e vlerës totale të kontratës së koncesionit të palët e treta, duke siguruar në të njëjtën kohë një mundësi për tenderuesit që ta rritin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;

b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata planifikojnë t’u caktojnë palëve të treta.

21.2 Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik në përputhje me rrethanat.

Neni 22: Transferimi i të Drejtave

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

22.1 Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveç se nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari /partneri privat i mëparshëm.

22.2 Transferimi i kontratës së koncesionit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës.

22.3 Kur koncesionari/partneri privat është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të Subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e autoritetit kontraktues dhe të Ministrisë së Financave, përveç se nëse ky është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.

22.4 Autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha transferimet e planifikuara të kontratës, të cilat ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit në ndonjë mënyrë në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, ose të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga ky ligj.

22.5 Autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e Financave për transferimet e kontratës të bëra në përputhje me këtë nen.

Neni 23: Sigurimi i Kontrates

23.1 Brenda _____ ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontrates në vlerën dhe formën siç parashikohet në kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në vlerën e kërkuar brenda _____ ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.

Neni 24: Baza Ligjore

24.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

25.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

25.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Neni 26: Përfaqësimi i Palëve

26.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

26.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

26.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 27: Lajmërimet

27.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

27.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 28: Llogaritja e Afateve

28.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Shtojca 18

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

**KUSHTET E VEÇANTA
Punët**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është _____

1.2 Kontraktori është _____

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i kontrates në shumën _____ duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: _____

Neni 3: Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor

3.1 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor: _____

3.2 Adresa/pika e kontaktit: _____

Neni 4: Kantieri

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i sakte i venddodhjes se objektit qe do te realizohet):

Neni 5 Data e Fillimit

5.1 Kjo kontratë: _____

Neni 6: Lloji i Kontratës

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Shtojca 19

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*] [
Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[*Data _____*]

Për : [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emer të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

Procedura e koncesionit/ ppp: [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (*objekti*)

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Duke qene se:

- (*emri i Ofertuesit Fitues*) eshte shpallur fitues ne Proceduren Konkurruese per Marrjen me Koncesion/PPP te _____, me vendndodhje ne _____, sipas shkreses se (*emri i Autoritetit Kontraktor*) (me poshte referuar si "Autoriteti Kontraktor"), Nr. _____ Prot, date _____.____.____, "Njoftimi i Fituesit" ; dhe
- Ofertuesi Fitues ka paraqitur prane nesh Draftin e Kontrates te lidhur ndermjet tij dhe Autoritetit Kontraktor, "Per marrjen me koncesion/ppp te _____ ; dhe
- ne Kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne Kontrate; dhe
- (*emri i Bankes/i shoqerise se sigurimit*) eshte dakord te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

- jemi garantuesit e kontrates se siperpermendur deri ne shumën totale prej (*shuma ne shifer dhe fjale*), shume e cila është e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate ; dhe
- marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej (*shuma e garancise*); dhe
 - per marrjen e kesaj garancie, nuk eshte nevoja t’i drejtoheni me pareKoncesionarit\Partneritetit Publik Privat per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj; dhe
- asnje shtesë apo ndryshim i kushteve te Kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me Koncesionarin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin _____ dite nga data e leshimit teCertifikates se Perfundimit.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 20

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATËS SE NËNSHKRUAR

Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja në Internet _____

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion Qëndror

Institucion i Pavarur

Njesi e Qeverisjes Vendore

Seksioni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Lloji i Kontratës

Shërbime

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

- 1.Objekti i kontratës _____
2. Forma e Kontratës _____
3. Burimi i Financimit _____

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në **muaj** **ose ditë**

ose

duke filluar nga / / me përfundim në / /

Seksioni 3 Procedura

3.1 Lloji i procedurës:

	E	Me
E hapur	kufizuar	negocim me shpallje paraprake

3.2 Numri i ofertave të dorëzuara:

Numri i ofertave të rregullta:

Seksioni 4 Informacion mbi kontratën

4.1 Numri i Kontratës: _____

Data e Kontratës/ /

4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Adresa e Internetit _____

4.3 Vlera Totale

Vlera _____ (pa TVSH) Monedha _____

4.4 Informacione shtesë (nëse ka)

“Për Hartimin , Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi / /

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Shtojca 21

FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ankesë drejtuar : *Autoriteti Kontraktor*

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërorish).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë
edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe
prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë
prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për koncesionin/ppp në fjalë (Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar (PK), Procedurë me Negociim me shpallje paraprake (PN).

2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e koncesionit/ ppp.

3. Vlera e Përlogaritur e Koncesionit/PPP

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/ shërbimeve që blihen.

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.

*Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për koncesionin/ ppp, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

4.Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit kontraktues. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepermjet faksit, etj).

Po **Jo**

2. Autoriteti Kontraktues pranë të cilit është bërë kundërshtimi
Emri i autoritetit kontraktues.

Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.

3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese
Çfarë mase korrigjuese kërkoni?
-

4. Lista

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e procedures konkurruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për konkurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: **Autoriteti perkates sipas ligjit nr. 125/2013 “Per koncensionet dhe partneritetin publik privat”**

Nr. Faks: E-mail:

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shënim:

Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Shtojca 22

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

FORMULARI I PROKURËS

Sot më datë, muaji, viti

Perpara meje

Noterit/es

I/E nenshkruari/a z./zj. _____

ne cilesine e tij/saj _____

Shtetesia _____

Mbajtes i Pasaportes ose Dokumentit te Identifikimit nr. Leshuar nga _____

Me date _____

Banues ne _____

Emeroj z./zj. _____ ne cilesine e tij/saj si _____, per te:

- (a) nenshkruar ose vulosur dhe per te dorezuar tek autoritetet kompetente te gjithë dokumentet e renditura ne Pasqyrën 1 bashkelidhur;
- (b) dorezuar dhe marre ne dorezim cdo lloj dokumenti apo instrumenti ne lidhje me dokumentet e renditura në Pasqyrën 1 bashkelidhur; dhe
- (c) Te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme ose shtese ne lidhje me ceshtjet e percaktuara ne kete dokument, perfshire edhe nenshkrimin dhe zbatimin e cdo akti, i cili nevojitet per te zbatuar per te plotesuar dokumentet e listuar ne Pasqyrën 1, ose qe keto dokumente te sjellin pasoja.

Dhe eshte i/e autorizuar te emeruje persona te tjere per te ushtruar te gjitha ose nje pjese te tagrave te percaktuara ne kete Prokure

ⁱ Shtuar me VKM Nr. 401 date 13.5.2015